

MAZHORANCA

Ndoka braktis opozitën, firmos koalicionin me PS

Pas PDK edhe Zef Bushati me ADK kalon me mazhorancën. Vangjel Dule dhe Paskal Milo vendosin sot

► **FAQE 2-3**



OPOZITA

Agjensi informative për kundërshtarët e PD

Mediu kritikon PD: Kandidatët e opozitës duhet të zgjidheshin nga baza e jo nga Tirana

► **FAQE 5**

[SHQIPTARJA.com]

LEKË 30

VITI V - NR. 91 - E MARTË - 21-04-2015

FORMULA E RE E LLOGARITJES

PENSIONET

FSHATI DHE QYTETI SA LEKE MARRIN 590 MIJE PENSIONISTET

Shuma që përfitohet për pagat, 30.000, 40.000 dhe 50.000 lekë. Specialistët e Insitutit të Sigurimeve Shoqërore, shpjegojnë për gazetën sa para marrin sot pensionistët e rinj

► **FAQE 8-9**

PARTNERITETI



Firmoset marrëveshja e partneritetit me SHBA

Kerry: Ju mbështesim për në BE. Bushati: Rritje e bashkëpunimit

► **FAQE 6**

OPINION

NGA **ILIR DHIMA**



Ka diçka që nuk shkon në jetën tonë

Po, vërtet ka diçka që nuk shkon në jetën tonë. Kjo po shquhet akoma më mirë javët e fundit, kur pasojat e shpimeve për naftë në interes vetëm e vetëm të një kompanie private të huaj, siç është 'Bankers Petroleum', në kupë të qiellit ngritën dhimbjen e një komuniteti të tërë njerëzish të thjeshtë në Marinë. Për vite me radhë që nga 2004 - a e më pas, ata kanë jetuar më frikën e shpërthimeve në këmbët e tyre, me makthin se ndonjë natë shtëpitë do t'u binin mbi kokë në gjumin e trazuar.

► vijon në faqen 18

TENDERI

► **FAQE 8**

Bashkia e Fierit shpall koncesion 7-vjeçar dy muaj para zgjedhjeve

Pas tenderave të anuluar në Vlorë e Tiranë për parkingjet, tani gara në Fier më 1 qershor

Shqipëri ÇDO TË HËNË, TË MËRKURË DHE TË PREMTE

TIRANA

Bari, Brindisi dhe Pescara

nga **49 EURO**

Të përfshirë dhe bagazhet në çmim

Balkan express Për informacione e prenotime +355 42 251837

Na ndiqni në **Facebook** **YouTube** **www.balkanexpress.it**

ARRESTIMI



Pranga 73-vjeçarit, ngacmonte vajzat në Qytetin e Studentit

BMC Blue Medical Center

Vizita, Analiza & Diagnostikim
Të garantuara
sipas protokolleve të
njekësive bashkëkohore
nga Blue Medical Center

Të parandalosh, më mirë se të kurosh!

Adresa: Rruga "Bardhyl" Nr.101, Tiranë Cel: +355 66 20 90 008
Tel: + 355 4 2370 868 Email: info@bmc.al, www.bmc.al

» ZGJEDHJET

SINJALET për afrimin me PS, kreu i PDK, Nard Ndoka i dha për "Shqiptarja.com", kur deklaroi se ishte në pritje të një oferte nga kryeministri Rama për të bashkëpunuar në Bashkinë e Kurbinit

Nard Ndoka braktis opozitën firmos koalicionin me Ramën

PS i rrëmben PD edhe Zef Bushatin e ADK, blindon të majtën

JUXHIN MUSTAFARAJ
TIRANË

Kryetari i Partisë Demokratike Nard Ndoka ka firmosur dje marrëveshjen për të qenë pjesë e koalicionit parazgjedhor me kryeministrin Rama. Pasi braktisi koalicionin me Partinë Demokratike, Ndoka deklaroi për "Shqiptarja.com" se ishte në pritje të një oferte nga kryeministri Rama për të bashkëpunuar në ato njësi vendore në të cilat PS nuk ka deklaruar ende emra kandidatësh, zona në të cilat PDK ka edhe një mbështetje të konsiderueshme. Duket se ka qenë pikërisht bashkia e Kurbinit, njësi që ka afuar në bashkëpunim Partinë Socialiste dhe kreun e PS Edi Rama me kreun e PDK-së Nard Ndoka. Pritet që në bazë të një marrëveshjeje të nënshkruar ditën e djeshme, PS në këtë bashki të mbështesë kandidatin e propozuar nga partia e Nard Ndokës. Kreu i PDK-së Ndoka ka zgjedhur që sqarimin për këtë angazhim të ri politik larg opozitës dhe bashkëpunimit me mazhorancën ta shpjegojë nëpërmjet një njoftimi për mediat. "Partia Demokratike nuk krijoi asnjë hapësirë për PDK-në në zgjedhjet lokale", është shprehur Ndoka. Largimi i PDK-së përbën për opozitën jo vetëm një aleat më pak, por edhe një deputet më pak për shkak se Ndoka e ka marrë mandatin e tij në Kuvend duke qenë pjesë e listave të Partisë Demokratike. Afrimi i Ndokës me Ramën vjen pas shkëputjes që kreu i PDK-së i bëri aleancës me PS-në në vitin 2013, kur kryeministri refuzoi ta fus në listat shumëemërore të PS. Në limitet e afateve të nënshkrimit të aleancave parazgjedhore, kryeministri Rama i ka "rrëmbyer" edhe një tjetër forcë politike Partisë Demokratike. Kështu krahas kreut të PDK-së Nard Ndoka edhe kreu i Aleancës Demokratike Zef

Bushati firmosi dje për të qenë pjesë e koalicionit të mazhorancës. Bushati njësoj si Ndoka ka braktisur kreun e PD-së, Lulzim Basha për shkak të pakënaqësive që ka pasur lidhur me mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve në zgjedhjet e 21 qershorit.

Këto zgjedhje kanë shërbyer për kryeministrin Rama për të shtuar jo vetëm numrin e forcave politike në koalicionin e majtë por edhe numrin e votave në parlament. Kështu nga 68 subjekte politike të regjistruara në KQZ për të konkuruar në këto zgjedhje, 42 prej tyre bëjnë

pjesë në koalicionin e majtë ndërkohë që rreth 15 të tjera do të jenë në koalicion me të djathtën. Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet e Shpëtim Idrizit, ishte e para që firmosi me kreun e PS-së Rama dhe pas saj me rradh, FRD e Bamir Topit, Partia Maqedonase e

cila ka marrë kandidatin në Bashkinë e Pustecit. Pritet që mes kryeministrin Rama dhe kreut të PDK-së, Nard Ndoka veç bashkëpunimit për kandidatin e Bashkisë së Kurbinit, të ketë edhe bashkëpunim në qeveri, ku PDK pretendon disa poste të nivelit të dytë.



Ndoka
PDK vendosi të ndërpresë negociatat me PD. Kryesia shqyrtoi ofertën për bashkëpunim dhe bashkëqeverisje të Partisë Socialiste dhe vendosi të bëhet pjesë e koalicionit zgjedhor të drejtuar nga koalicioni qeverisës

Afatet
Dule dhe Milo vendosin sot, PBDNJ mban pezull Dropullin e Pustecin

— Kreu i PBDNJ-së Vangjel Duke dhe kreu i PDS-së Paskal Milo do të vendosin sot në limitet përfundimtare të afateve për regjistrimin e koalicioneve zgjedhore në të bashkëpunojmë me kreun e PS-së Edi Rama apo jo. Pavarësisht tentativave të vazhdueshme nga nënkryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla për të zhvilluar një takim me nënkryetarin e Kuvendit Dule, shpallja e kandidatit nga e majta për Bashkinë e Himarës ka lënë pezull negociatat. Megjithatë në përmbytje të fjalës së tij, kreu i PS-së Edi Rama ka ende të lira për PBDNJ-në e Vangjel Dules, bashkinë e Dropullit



dhe atë të Finiqit. Megjithëse ka deklaruar se është në bisedime me PS-në, Dule ka mohuar të jetë në negociatat të cilat pavarësisht rezultateve që do të kenë duhet të shpallen sot. Të njëjtin vendim do të duhet të marr sot edhe kreu i PDS-së, Paskal Milo. Pavarësisht se kishte theksuar se këtë vendim do ta merrte këtë të shtunë pas mbledhjes së Këshillit Kombëtar të partisë së tij, Milo vendosi t'i shtyjë negociatat me Ramën. Kërkesa kryesore në drejtim të kryeministrin nga Paskal Milo është ajo për respektimin e marrëveshjes së nënshkruar për zgjedhjet e vitit 2013. Në të kundërt, Milo ka deklaruar se do të dal bashkë me Gjinushin në një pol të treta brenda së majtës.



SKADOJNË AFATET

Partitë politike firmosin sot deri në 18:00 për koalicionet

Mazhoranca në pritje të tre aleatëve, opozita e gjitha me 15 parti

Subjektet politike të regjistruara në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve për zgjedhjet e 21 qershorit, kanë afat deri në orën 18:00 të ditës së sotme për të deklaruar koalicionin në cilin do të bëjnë pjesë ose në të kundërt do të dalin të vetme në zgjedhje. Marrëveshjet e nënshkruara paraprakisht nga forcat politike,

pritet të përfundojnë edhe me pozicionimin e fundit që disa parti do të bëjnë deri pasditën e sotme. Neni 65, pika 1 e kodit zgjedhor parashikon që dy ose më shumë parti politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ, mund të regjistrohen si koalicion në shkallë vendi jo më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Dy kampet e

mëdha politike PD dhe PS thuajse kanë përfunduar marrëveshjet me partitë e vogla dhe pritet që brenda këtij afati të dorëzojnë në KQZ listat e plotat të koalicioneve. Partia Socialiste dhe aleatët e saj e zgjeruan koalicionin e majtë me rreth 42 parti, jo vetëm të spekttrit të majtë, por edhe të krahit të djathtë, bashkë me afrimet e djeshme të Nard Ndokës dhe Zef Bushatit. Pjesë e koalicionit të majtë është bërë edhe Fryma e Re Demokratike e drejtuar nga ish-Presidenti, Bamir Topi dhe Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet e Shpëtim Idrizit. Të majtën do të presin sot të firmosin me aleatin e deritanishëm në qeverisje, Vangjel Dule të PBDNJ-së dhe dy aleatët historik të PS-së, Paskal Milo dhe Skënder Gjinushi. Ndërkohë që marrëveshja mes partive të koalicionit opozitar pritet të nënshkruhet ditën e sotme, ku ndryshe nga koalicionet e zgjeruar që firmoste ish-kryeministri Berisha kur ishte në drejtimin e PD, këtë radhë do të jenë vetëm 15 forca politike që do të bëjnë pjesë në koalicionin opozitar.



Ligji
Neni 65, pika 1 e kodit zgjedhor parashikon që dy ose më shumë parti politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ, mund të regjistrohen si koalicion në shkallë vendi jo më vonë se 60 ditë përpara zgjedhjeve



KRYEMINISTRI
Rama do të jetë sot në Bruksel për një takim të rëndësishme në kuadër të procesit të Berlinit për bashkëpunimin e zhvillimin ekonomik të rajonit

MAZHORANCA

JUXHIN MUSTAFARAJ
TIRANË

Negociatat me aleatët e mbetur të cilët do të dakordësojnë për të qenë pjesë e koalicionit të majtë dhe Partinë Socialiste do të udhëhiqen nga nënkryetari i grupit parlamentare të PS-së, Taulant Balla. Kryeministri Edi Rama nuk do të jetë sot në Tiranë për shkak se ndodhet në Bruksel për një takim të rëndësishëm në kuadër të procesit të Berlinit për bashkëpunimin ekonomik në vendet e rajonit. Njoftimin për këtë takim e ka dhënë vetë kryeministri Edi Rama, mbrëmjen e djeshme në "facebook". "Në Bruksel për një ditë të rëndësishme në kuadër të procesit të Berlinit për bashkëpunimin e zhvillimin ekonomik të rajonit tonë", ka shkruar Rama. Kështu takimet me aleatët e mbetur, pritet të realizohen sot nga nënkryetari i grupit dhe i përzgjedhuri i Ramës për koordinimin e aleatëve të mazhorancës, Taulant Balla. Sytë e PS-së janë nga Partia për Bashkimin dhe të Drejtat e Njeriut, e cila ende nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Një tjetër pritshmëri në kampin rozë ka edhe për partitë e dy aleatëve historikë Gjinushi e Milo, të cilët para orës 18:00 do të vendosin nëse do të vijojnë të qëndrojnë me PS apo do të dalin të vetëm në zgjedhjet e 21 qershorit.

MANDATET
Përfundimi i afateve ligjore për regjistrimin e koalicioneve zgjedhore do të pasohet nga një tjetër proces, ai i lënies së mandateve nga deputetët që do të garojnë në këto zgjedhje vendore. Do të jenë tetë deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, katër nga mazhoranca dhe katër nga opozita të cilët do të garojnë në këto zgjedhje vendore. Afati maksimal ligjor që ligjvënësit kanë për të lënë mandatet e tyre është data 2 maj. Sipas procedurave, deputetët duhet të depozitojnë

Aleancat **Negociatori** **Afatet**

Negociatat parazgjedhore për kreun e PS mund të quhen të suksesshme pasi veç aleatëve të rinj ka shtuar numrat e mazhorancës me PDIU e Shpëtim Idrizin dhe PDK e Nard Ndokës

Takimet me aleatët e mbetur nga mazhoranca, pritet të realizohen sot nga nënkryetari i grupit dhe i përzgjedhuri i Ramës për koordinimin e aleatëve të mazhorancës, deputeti Taulant Balla

Përfundimi i afateve ligjore për regjistrimin e koalicioneve zgjedhore do të pasohet nga lënia e mandateve nga deputetët e Partisë Socialiste e PD që do të garojnë në zgjedhjet e 21 qershorit

Rama sot në Bruksel, Balla negociator për aleancat e fundit

Pas aleancave startojnë dorëheqjet e deputetëve. Ja afatet që parashikon ligji

Kandidimi në Zgjedhje

8 deputetët që lënë mandatet
Nga mazhoranca dhe opozita do të jenë 8 deputetë që do të lënë mandatin për të kandiduar në zgjedhje. Armando Subashi(PS)në Fier, Artur Bushi(PS)në Krutje, Majlinda Bufi(PS), në Roskovec dhe Miranda Rira(LSI),në Prrenjas, Ardian Turku(PD) në Elbasan; Besnik Duzhaj(PD) në Tropojë; Voltana Ademi në Shkodër dhe Halim Kosova në Tiranë



Opozita

Pakënaqësi në PD për largimet e aleatëve dhe aleancat me Ramën

Largimet e disa forcave politike nga koalicioni me Partinë Demokratike dhe marrëveshjet e nënshkruara me kryeministrin Rama duket se kanë nxehur gjakrat brendat kampit blu. Largimi i djeshëm i Nard Ndokës, aleat i dalë nga listat shumëemërore të Partisë Demokratike në Shkodër ka shtuar pakënaqësitë në PD. Disa prej deputetëve demokratë i kanë cilësuar si të dështuara negociatat që kreu i PD-së Bash aka kryer me aleatët e tij, duke e shpjeguar në këtë mënyrë edhe largimin e disa aleatëve kryesorë. Largimi i Shpëtim Idrizit të PDIU-së, ishte edhe humbja më e madhe e PD në prag të zgjedhjeve vendore, ku bashkë me ikin e partisë së çamëve u larguan edhe katër vota të tyre, pasi Tahir Muhedini ka vendosur të qëndrojë në opozitë. Edhe deputetja Mesila Doda pak ditë më parë i cilësoi të dështuara negociatat e kreu të PD-së Bash me aleatët, duke kujtuar se teksa erdhi në krye të PD-së kryedemokratit premtosi se do të bashkonte të djathtën.



në Këshillin e Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit në Kuvend kërkesën për lënien e mandatit, duke i hapur rrugën kandidimit të tyre në zgjedhjet e ardhshme. Nga mazhoranca do të largohen: Armando Subashi (PS), për kryetar bashkie në Fier, Artur Bushi(PS), për kreun e bashkisë Krutje; Majlinda Bufi (PS), për bashkinë Roskovec dhe Miranda Rira(LSI), për bashkinë e Prrenjasit. Ndërsa nga opozita do të largohen jetës parlamentare: Ardian Turku (PD), i cili do të jetë kandidat për bashkinë e Elbasanit; Besnik Duzhaj për bashkinë Tropojë; Voltana Ademi për bashkinë Shkodër, si dhe Halim Kosova, kandidat i PD-së për bashkinë Tiranë. Pas miratimit të kërkesës së tyre nga Këshilli për Rregulloren dhe Mandatet, Kuvendi, jo më vonë se 30 ditë njofton KQZ-në për krijimin e vakancës. Mandati i ndëprerë i kalon kandidatit vijues të listës së së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse.

PARTITË QË KANË FIRMOSUR NË KOALICIONIN E MAJTË

Partia Socialiste e Shqipërisë	Edi Rama
Lëvizja Socialiste për Integrim	Ilir Meta
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	Shpëtim Idrizi
Partia Demokratiane	Nard Ndoka
Aleanca Arbore Kombëtare	Gjet Ndoj
Aleanca Demokratike	Eduard Abazi
Aleanca e Maqedonasve	Edmond Themelko
Aleanca për Barazi e Drejtësi	Valentino Mustaka
Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	Gaqo Apostoli
Partia Ambientaliste	Nasi Bozheku
Partia Aleanca Demokratike	Zef Bushati
Partia Ardhmëria Shqiptare	Emin Subashi
Partia Demokracia e Re Europiane	Koçi Tahiri
Partia Demokratike e Bashkimit Mysliman	Osman Mema
Partia e Çështjeve Shqiptare	Bujar Shurdhi
Partia e Gjelbë	Edlir Petani
Partia Kristandemokrate	Mark Frruko
Partia e Pajtimit Kombëtar	Spartak Dobi
Partia e Punës e Shqipërisë	Muharrem Xhafa
Partia e Reformave Demokratike	Skënder Halili
Partia e të Drejtave të Mohuara	Ilir Vata
Partia Forca Rinia,	Dritan Broka
Partia e Unitetit Kombëtar	Idajet Beqiri
Partia G99	Ervin Mete
Partia Komuniste e Shqipërisë	Qemal Cicolari
Partia Komuniste 8 Nëntori	Preng Çuni
Partia Lëvizja Demokratike	Nikolin Staka
Partia Lëvizja për Drejtësi	Astrit Kosturi
Partia Lëvizja Punëtores	Shefqet Musaraj
Partia Ligji dhe Drejtësi	Spartak Ngjela
Partia Mendimi i Djathtë Liberal	Mustafa Lici
Partia për Europianizimin dhe Integrimin	Rivelino Çuno
Partia për Mbrojtjen e Emigrantëve	Ymer Kurti
Partia Personat me Afësi të Kufizuar	Afrim Jeshili
Partia Rrugë e Lirisë	Kurt Kola
Partia Shqiptare Atdheu	Kreshnik Osmani
Partia Socialiste e Moderuar	Gjergji Koja
Partia Socialiste e Vërtetë '91	Petro Koçi
Partia Socialpunëtore	Ramadan Ndreka
Partia Toleranca e Re	Avdi Keçi

» ZGJEDHJET

KREU i PS-së së Tiranës dhe Sajmir Tahiri, dje pas mbledhjes së grupit parlamentar të PS deklaroi se Rama ka bërë përzgjedhjen e duhur me Erion Veliajn

Veliaj javën tjetër ikën nga ministria, i përkushtohet fushatës

Kandidati i PS pas senatorëve merr mbështetje edhe nga Sajmir Tahiri: I duhuri për Tiranën

JUXHIN MUSTAFARAJ
TIRANË

Kandidati i Partisë Socialiste për Bashkinë e Tiranës, Erion Veliaj do të jap dorëheqjen nga posti i Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë javën e ardhshme. Vendimin për këtë largim e ka dhënë vetë ministri Veliaj dje në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Punës. Ky vendim sipas ministrit Veliaj do të merret për shkak të përkushtimit që ai do të ketë për fushatën zgjedhore për Bashkinë e Tiranës dhe programin që do të hartojë për ta paraqitur në fushatë. “Duke qenë se mbledhja tjetër do jetë me një ministër të ri, do të doja të kishim në rregull punën në Këshillin Kombëtar, derisa të merret stafeta aty ku është lënë. Dhe kështu do të bëj deri javën tjetër kur do paraqes dorëheqjen, për t’u siguruar që puna e nisur të ketë përfunduar dhe që puna të jetë gati për kolegun pasardhës”, u shpreh Veliaj. Ministri gjatë mbledhjes së djeshme tha se ministria që ai ka drejtuar për 2 vite ka arritur të realizojë reforma rëndësishme, të cilat kanë patur një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e njerëzve. “Pavarësisht dallimeve që kemi për të mbrojtur interesat e biznesit apo të sindikatave, ne arritëm të ndërtonim një formulë në këtë ekip, duke prodhuar produkte ku kishte të fituar dhe jo të humbur, ku kishte formula të tipit ‘win win’”, tha Veliaj. Realizimin e premtimeve të mbajtura, Veliaj po e lançon edhe nëpërmjet profilin të tij në “facebook”. Ndërkohë që në këtë javë të parë pas lancimit të emrit të tij si kandidat zyrtar i mazhorancës për Bashkinë e Tiranës, Veliaj ka marrë mbështetje edhe nga kreu i PS-së së Tiranës dhe ministri i Brendshëm, Sajmir Tahiri. Dje pas mbledhjes së grupit parlamentar të PS, Tahiri deklaroi se kryeministri Rama ka bërë përzgjedhjen e duhur me Erion Veliajn për Bashkinë e Tiranës. “Padyshim do ta mbështes kandidaturën e Veliajt. Është i duhuri për Tiranën”, u shpreh ministri Tahiri. Mbështetja për kandidatin e mazhorancës Erion Veliaj nga kreu i PS-së për Tiranën Sajmir Tahiri, vjen pas mbështetjes

që dhanë fillimisht Pandeli Majko dhe Luan Hajdaraga. Mbështetje për kandidimin e Veliajt ka dhënë edhe komuniteti i biznesit. Kryetari i Biznes Albania, Luan Bregasi vlerësoi frymën që Veliaj futi gjatë kohës që drejtoi ministrinë. “Erjoni futi në këtë mbledhje metodën e raportimit dhe të përgjegjësisë së institucioneve ndaj problemeve që ngre biznesi. Futi një koncept të ri në zyrat e punës. Ne patëm vjet 40

mijë vende pune të reja”, deklaroi Bregasi. Mesazh urimi në lidhje me kandidimin e tij në Tiranë ka ardhur edhe nga shkrimtari britanik dhe ish-këshilltari i Toni Bler Alastair Campbell i cili përmes rrjetit social “Tëitter” ka vlerësuar kandidimin e Veliajt në zgjedhjet lokale. “Fat të mbarë Erjon Veliaj për dy javët e tij të fundit si ministër përpara se të hyjë në garë për Bashkinë e Tiranës. I ri dhe i talentuar” shkruan Campbell.



Sajmir Tahiri



Alastair Campbell, këshilltar i Toni Bler

Berisha: Veliajn e kam pëlqyer, punova me të kundër Nanos

“Halim Kosova është një kandidat i fitores, me vizion të qartë”



Ish-kryeministri Berisha, në një konferencë për mediat gjatë ditës së djeshme është ndalur tek zgjedhjet lokale, dhe konkretisht tek gara për bashkinë e Tiranës. Duke parë si një kandidat fitues Halim Kosovën dhe nga ana tjetër duke hedhur baltë mbi kandidatin e mazhorancës Erion Veliaj, ai nxjerr në pah një moment interesant të bashkëpunimit me këtë të fundit. Ish-kryeministri Berisha e pranon se gjatë bashkëpunimit me Veliajn kundër Nanos, e ka pëlqyer kandidatin e mazhorancës. Ndërsa tanimë që ai është përballë kandidatit të PD-së për bashkinë e Tiranës, nuk

Qëndrimi

PD nis fushatën e akuzave kundër kandidatit të PS



Parita Demokratike ka nisur dje fushatën e akuzave ndaj Erion Veliajt. Nëpërmjet një conference për shtyp deputeti Gerti Bogdani, është shprehur se Veliaj nuk ka bërë asgjë gjatë viteve të mandatit të tij në krye të ministrisë, në këtë mënyrë ai nuk do të bëjë asgjë për Tiranën nëse zgjidhet për të drejtuar Bashkinë. “Si ministër i kësaj qeverie, ai është mbështetës i çdo mase të kësaj qeverie që ka vështirësuar jetën e qytetarëve, me rritjen e taksave, me rritjen e cmimit të energjisë, me prishjen e pronave të ndërtuar me djersën e shqiptarëve të ndershëm. Ai nuk ka kundërshtuar asnjë herë të vetme asnjë vendim të kesaj qeverie që në këto dy vite i ka përkeqësuar kushtet e jetesës qytetarëve shqiptarë”, tha ai.



KANDIDATI

Kosova takon kolegët, i japin mbështetje në fushatë

Kandidati i PD për Tiranën, Halim Kosova ka takuar pasditen e djeshme kolegët e tij mjekë, të cilët i kanë dhënë atij mbështetje për zgjedhjet e 21 Qershorit. Pas një kafeje mes kolegësh që zgjati për rreth 30 minuta, Kosova doli i shoqëruar nga kolegët e tij, ndërsa kirurgu Arben Beqiri tha për mediat se Kosova do të shërbejë si një katalizator për ecjen para të qytetit. “Besojmë shumë që me moshën dhe eksperiencën e tij të madhe ku pati arritje të mëdha profesionale në zhvillimin e mjeksisë, vjen kësaj here si kandidat për Bashkinë e Tiranës, për për të dhënë edhe më shumë për qytetin dhe qytetarët e tij”, tha Beqiri.

MESAZHI

Lulzim Basha i beson dekriminalizimin Pollos

Kreu i PD prezanton Hilën në Vaun e Dejës: Oferta më e mirë

Partia Demokratik me urdhër të kreut demokrat Basha po ngre brenda saj tashmë një strukturë informale, të tipit shërbim informativ, në funksion të dekriminalizimit. Deputetët demokrat tashmë janë

udhëzuar për mënyrën e dhënies së informacionit për kundërshtarët e tyre politik dhe se ku duhet ta adresojnë informacionin që kanë mbledhur. Genc Pollo dhe Endira Bushati, do të jenë mbledhësit e ata që do të grumbullojnë informacionin që deputetët demokrat do të mbledhin, për persona të korruptuar apo me precedent penal. Një njoftim i tillë për deputetët demokrat është bërë i ditur nëpërmjet një mesazhi që kreu i grupit parlamentar demokrat, Edi Paloka, u ka nisur deputetëve të PD-së duke iu sqaruar gjithë mënyrën e mbledhjes dhe dhënies së informacionit në shërbim të dekriminalizimit të administratës publike.

PREZANTIMI

Kreu demokrat Basha ka prezantuar dje

në Vaun e Dejës kandidatin e PD-së për këtë bashki Zef Hila. Gjatë prezantimit të Hilës, kreu i selsisë blu Basha akuzoi kryeministrin Edi Rama dhe aleatin e tij në qeverisje se janë rreshtuar në radhët e kriminelëve dhe nga ana tjetër godasin qytetarët. 21 Qershor, sipas Bashës, do të jetë dita kur kjo mazhorancë të marrë përgjigjen me votë. "Më 21 qershor do të votojmë të gjithë bashkë, për t'i treguar Ilir Metës dhe Edi Ramës se banorët e kësaj zone nuk e ulin kokën para poshtërimit, nuk mund ta pranojnë politikën e lakut në fyt që i lë pa bukë në tryezat e tyre, ndërkohë që mbush kontot dhe valixhet e qeveritarëve të korruptuar Ilir Meta dhe Edi Rama. I godasin qytetarët e pafajshëm e të pamundur, po i mbrojnë mafiozët e kriminelët Ilir Meta dhe Edi Rama që ulen e hanë në sofrën e tyre", theksoi Basha. Kreu i demokrat tha se oferta e PD-së është ulja e taksave, e çmimit të naftës dhe hapja e vendeve të reja të punës.



Premtimi

"Pas 21 qershorit na pret një rrugë tjetër, e shpresës, e ringritjes, e mirësisë, e përpjekjeve tona për të ulur çdo taksë, për t'i çuar të gjithë paratë në zhvillimin e ekonomisë", tha Basha.



Asambleja

ERMIRA MRRUKU
TIRANE

Mediu kritikon Bashën: Lojë e pandershme me Dukën

"Kandidatët e opozitës duhet të zgjidheshin nga baza"

Në kushtet kur mes Partisë Demokratike dhe Partisë Republikane është nënshkruar një marrëveshje parazgjedhore tashmë, kreu republikan Fatmir Mediu ka drejtuar dje në mënyrë indirekte kritikën e tij ndaj kreut demokrat Basha. Edhe pse tashmë episodin e mosmarrëveshjeve mes republikanëve dhe demokratëve për çështjen "Duka" e çuan një ngjarje të kapërcyer, Mediu gjatë mbledhjes së asamblesë së PR-së dje u shpreh se për kandidaturën e Agron Dukës në Durrës, u lajt në mënyrë të jo të ndershme. "Agron Duka në zgjedhjet e fundit parlamentare kaloi çdo parashikim të Partisë Republikane në Durrës me mbështetjen e madhe që siguroi. Ne nuk e kërkua, por Dukës ju kërkua

të kandidonte në këtë bashki. Ai pranoi pasi në Durrës për 15 vjet e djathta nuk ka fituar asnjëherë dhe Duka mund t'i kthente drejtimin e bashkicë

të djathtës në këtë qytet. Kjo është një histori tashmë e tejkaluar por jo e luajtur në mënyrë të ndershme siç shprehu edhe vetë Duka. Ne do të

japim mbështetjen për të fituar zgjedhjet në këtë bashki por edhe në çdo bashki tjetër të vendit", tha Mediu. Ndërkohë që Mediu u shpreh kundër

zgjedhjes nga kryesia e Tiranës të kandidatëve të koalicionit të djathtë për zgjedhjet lokale. Kreu republikan tha se do të ishte shumë më mirë që emrat e kandidatëve për kryetarë bashkie të dilnin qytetet ku ata garojnë për të udhëhequr. Në këtë kontekst, Mediu tha se Agron Duka do të ishte kandidatura më e mirë për bashkinë e Durrësit duke marrë parasysh pikërisht përkrahjen që

Duka pati nga Durrësi. "Zgjedhjet lokale janë një mundësi e opozitës për të dëgjuar zërin e qytetarëve, ndaj ajo duhet të bazohet tek ky zëri i qytetarëve dhe jo tek ardhja në pushtet. Në këto zgjedhje opozita duhet të kapërcente interesin partiak, për të patur kandidatët personal të saj më të mirë, për t'ju thënë qytetarëve se po shikohen interesat e tyre dhe jo ato partiake", tha Mediu.

Largimi nga strukturat

PR, dorëhiqet Alibali dhe sekretari politik Baze

Pas nënshkrimit të marrëveshjes së Partisë Republikane dhe Partisë Demokratike për koalicionin të përbashkët në zgjedhjet e qershorit Partia Republikane ka humbur dy prej figurave të saj. Në takimin e kryesisë së Partisë Republikane nënkryetari i kësaj force Neritan Alibali si dhe sekretari për çështje politike Olsi Baze kanë deklaruar se nga sot dorëhiqen dhe nuk do të jenë më pjesë e Partisë Republikane. Largimi i tyre nga drejtimi i strukturave të partisë është justifikuar me një tërheqje për arsye personale nga politika. "Unë kam

deklaruar që në prill 2013 që nuk do të rikandidoj më për postet drejtuese në PR, dhe këtë e kam lidhur me bindjen time mbi nevojën e lëvizjes së elitave, jo vetëm në PR por edhe në partitë e tjera. Vendimi im lidhet me dhënien e një modeli, për tu larguar dhe për t'i lënë hapësirë një brezi të ri brenda partisë", tha Alibali. Ndërkohë që dorëheqja e dy anëtarëve të PR vjen në një kohë kur Partia Demokratike me të cilën është nënshkruar tashmë një marrëveshje koalicioni refuzoi propozimin e republikanëve për të kandiduar Agron Dukën në Bashkinë e Durrësit.

"Historia për Agron Dukën tashmë e tejkaluar por nuk është luajtur në mënyrë të ndershme"

OFERTË PUNËSIMI

Një kompani mediatike kërkon të punësojë **menaxher marketing**, part-time nëpër rrethet që plotëson kriteret e mëposhtme:

Të ketë arsim të lartë

Të ketë përvojë pune

Të jetë i gatshëm për të punuar në terren

Personat e interesuar të dërgojnë CV-të e tyre në adresën: auronashkoza84@yahoo.com

VIZITA

Kerry: Shqipëria, një mike e partnere e fortë e NATO-s

Ministri Bushati, vlerësim nga SHBA për angazhimin antiterror

Kreu i diplomacisë shqiptare Ditmir Bushati u prit në selinë e diplomacisë amerikane nga Sekretari i Shtetit, John Kerry, një kulmim i vizitës që ka nisur në SHBA që prej të premtes. Bushati e Kerry nënshkruan marrëveshjen e partneritetit strategjik SHBA-Shqipëri, në Uashington. "Shqipëria është një mike dhe partnere e fortë e NATO-s. Ajo bashkëpunon ngushtë me SHBA dhe me partnerët e tyre në një numër frontesh të ndryshme. Sot do kemi kënaqësinë të nënshkruajmë marrëveshjen SHBA-Shqipëri për partneritetin strategjik, një përpjekje për të bashkëpunuar më plotësisht për interesin tonë të përbashkët lidhur me luftën kundër terrorizmit, për sigurinë në rajon, kundër ISIS dhe nisma të tjera. Vitin

e kaluar në Uells pata rastin të takohem me Kryeministrin Edi Rama, ku diskutuam për shumë nga këto probleme e sot ne do ta vazhdojmë këtë diskutim. Shqipëria ka ndihmuar shumë në transferimin e njerëzve të grupit të rezistencës iraniane MEK dhe në çështjet tjera", tha Kerry. I cili ka ofruar gjithë mbështetjen e SHBA për integrimin e Shqipërisë në familjen evropiane. "Ne e mbështesim anëtarësimin e Shqipërisë në BE sa më shpejt që të jetë e mundur dhe ata janë në rrugën për të bërë gjërat e nevojshme për këtë anëtarësim. Jemi të kënaqur

që Shqipëria ka rënë dakord të bëhet mikpritëse e takimit ministerial për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm. Kjo ka rëndësi për të gjithë, duke patur parasysh njoftimet lidhur me aktet në të cilat është angazhuar ISIS. Po punojmë në përpjekjet e përgjithshme rajonale lidhur me luftën kundër ISIS e bashkëpunimi i Shqipërisë si anëtare e koalicionit ka qenë absolutisht i rëndësishëm", tha Kerry. Kreu i diplomacisë shqiptare, Ditmir Bushati nënvizoi se "Shqipëria dhe SHBA janë partnerë strategjikë e aleatë si në NATO ashtu dhe në organizata të tjera ndërkombëtare. Po punojmë ngushtë sëbashku në Irak, Afganistan, dhe më së fundi në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhun-

MINISTRI I JASHTËM shqiptar Ditmir Bushati mori mbështetjen e SHBA për integrimin në BE dhe vlerësimin për kontributin kundër terrorizmit

Romë/Takimi

Meta-homologët e BE: Veprime kriminale me emigrantët



Shqipëria për herë të parë në takimin e krerëve të Kuvendit të vendeve të Bashkimit Evropian, kjo fryt i marrjes së statusit të vendit kandidat për në BE. Kryetari i Kuvendit, Ilir Meta gjatë fjalës së tij në punimet e konferencës së kryeparlamentarëve të vendeve të Bashkimit Evropian deklaroi se me emigrantët po ndodhin veprime kriminale, dhe i takon Bashkimit Evropian që të marrë masa, por duke mos dëgjuar zërin e ekstremistëve. Gjithashtu Meta është ndalur edhe te situata në Ukrainë, duke e cilësuar si një situatë që tregon që në lojë ka akoma disa interesa gjeopolitike që na vënë në rrezik. "Duhet të imponojmë të shembim muret që nuk kanë efekt. Jemi në pozicionin e duhur për të theksuar se sa e rëndësishme lëvizja e lirë. Ukraina dhe Krimea na tregojnë se ka akoma interesa gjeopolitike që na vënë në rrezik. Me emigrantët po ndodhin veprime kriminale. Duhet t'u rezistojmë thirrjeve ekstreme. Parlamentet duhet të përqipen që të forcojnë dhe të trupëzojnë më tepër Bashkimin Evropian", tha Meta. Shqipëria merr pjesë për herë të parë në një takim të këtij niveli, me statusin e vendit kandidat, duke treguar qartë ambicet e saj për hapjen e negociatave për anëtarësimin e plotë në familjen e madhe evropiane, deri në anëtarësimin me të drejtë të barabarta. Gjatë qëndrimit në Romë, kryeparlamentari Ilir Meta do të pritë nga homologët italianë Laura Boldrini dhe Pietro Grasso, ndërsa do të zhvillojë takime dypalëshe me homologët të tjerë evropianë, që marrin pjesë në konferencë. Kryetari i Kuvendit gjatë vizitës së tij shoqërohet nga deputetët e Partisë Socialiste, Blendi Klosi dhe Fatmir Toçi.

AMBASADA

Për Bushatin, përmirësimi i kushteve të përfaqësimit në Uashington është një shenjë e qartë përgjegjësie si dhe një dëshmi konkrete e angazhimit ndaj aleatit strategjik.

Integrimi

"Ne e mbështesim anëtarësimin e Shqipërisë në BE sa më shpejt që të jetë e mundur dhe ata janë në rrugën për të bërë gjërat e nevojshme për këtë anëtarësim", tha Kerry.



Ministri i Punëve të Jashtme, Ditmir Bushati dhe Sekretari i Shtetit, John Kerry

Qëndrimi



TIRANE

Ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati, pas takimit me John Kerry tha se ka marrë mbështetjen e FBI për ngritjen e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Për Zërin e Amerikës, ai tha se vendimet e Kushtetueses do respektohen e se do gjenden rruga e duhur për të jetësuar këtë strukturë. "Jam i lumtur të ritheksoj mbështetjen që po marrim nga FBI për të përfituar nga procesi të ndërtimit të kapaciteteve administrative. Në jemi një demokraci kushtetuese e vendimet e Kushtetueses respektohen dhe besoj se ne do gjejmë rrugën e duhur për ta jetësuar këtë strukturë, kuptohet me vendimin e Kushtetueses dhe mbështetjes teknike që do marrim nga FBI në këtë drejtim", u shpreh ministri. Bushati komentoi dhe deklaratat e kryeministrit

"Do gjendet rruga e duhur për Byronë Kombëtare të Hetimit"

Bushati në VOA: Ritheksoj mbështetjen që po marrim nga FBI

Rama për Kosovën. "Nuk bëhet fjalë për një rrëshqitje në deklaratë, por bëhet fjalë për një keqinterpretimin apo nxjerrje jashtë konteksti, që kishte lidhje dhe me situatën paksa kritike ku ndodhet Kosova, ku perspektiva e anëtarësimin në BE po shtyhet përtej parashikimit sikundër edhe liberalizimi i vizave nuk po jetësohet. Më tepër ka qenë një qëndrim që buron prej një lloj situatë frustuese që do duhet të adresohet



përmes instrumenteve të qartë politikë, por është më rëndësi që qeveria shqiptare ka qenë e kthjellët që rruga e Shqipërisë drejt BE, integrimi i shqiptarëve kalon përmes një bashkëpunimi të ngushtë në radhë të parë me SHBA", tha ai. Për Bushatin, takimi me Kerry ishte i rëndësishëm, diskutimi, i grohtët. "Firmosëm dokumentin e partneritetit strategjik, thellojmë bashkëpunimin, është një bashkëpunim shpirtëror mes

dy kombeve tona jo si mes dy përfaqësuesish shtetesh", tha Bushati. Më tej ministri foli për rëndësinë që ka reforma në drejtësi. "Reforma në drejtësi është themelore për sundimin e së drejtës në ekonomi, për tërheqjen e investimeve të huaja dhe për integrimin. SHBA kanë investuar jo pak në këto dy dekada, sot jam i kënaqur ta konstatoj". Bushati foli edhe për një samit përsa i përket terrorizmit që do mbahet në Tiranë.

Faksimile e shpalljes së garës për koncesionin shtatëvjeçar të ndriçimit të qytetit të Fierit nga Bashkia

Bashkia e Fierit shpall koncesion 7-vjeçar 2 muaj para zgjedhjeve

Pas tenderave të anuluar në Vlorë e Tiranë për parkingjet, tani gara në Fier më 1 qershor

GENC KONDI
TIRANË

Pas nxitimit të drejtuesve të Bashkisë së Vlorës për të dhënë me koncesion për një afat shumë të gjatë parkimin e automjeteve në mjediset publike të qytetit të drejtimit të pushtetit vendor, edhe Bashkia Fier sapo ka njoftuar synimin për të dhënë për shtatë vjeç një koncesion të përmirësimit të ndriçimit publik të rrugëve të këtij qyteti.

Në njoftimin, e publikuar në buletin e prokurimit publik të ditës së djeshme, Bashkia shpall garën me objekt "Përmirësimi i Shërbimit të Ndriçimit Rrugor në Bashkinë Fier, nëpërmjet një modeli të Partneriteti Publik-Privat".

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin, theksohet në këtë njoftim, është shtatë vjet, duke nisur nga data e lidhjes së kontratës. Më tej, në shpallje theksohet se sigurimi i ofertës duhet të jetë



Bashkia e Fierit

sa 2% e vlerës së ofertës së propozuar dhe duhet të dorëzohet së bashku me ofertën.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është data 1 qershor 2015, ora 11:00.

FUND-MANDATI

Në rastin e koncesionit të parashikuar për Vlorën, pati një mobilizim të theksuar qytetar, por edhe politik, me Partinë Demokratike, që kërkoi anulimin e tenderave të rëndësishëm në fund-mandati. Ky anulim erdhi menjëherë, madje eliminimi nga gara për kryebashkiak edhe prefekten e Vlorës, Etjola Hoxha, duke qenë se ajo kishte patur dijeni për një garë të tillë dhe nuk kishte reaguar. Kështu, i gjithë opinioni reagoi duke dënuar dhënien e një koncesioni me afat shumë të gjatë në momentin kur Shpëtim Gjika duhej se nuk do të mbante më postin e kryetarit të Bashkisë. Dhe kjo u pasua nga anulimi i marrëveshjes.

Një përpjekje të tillë e bëri edhe kryebashkiaku i Tiranës, Lulzim Basha, i cili tentoi të japë me koncesion parkimin e makinave edhe në kryeqytet, por, nisur nga jehona negative pas masimit të këtij


lajmi, deklaroi më pas se do t'i kërkonte Këshillit Bashkiak të shtynte për pesë vjet dhënien me koncesion të hapësirave për parkingje publike në kryeqytet.

Më parë, edhe Bashkia e Elbasanit kishte tentuar të bënte një tender të ngjashëm, por e bllokoi shpejt.

NXITIMI

Në rastin e Vlorës, ka qenë qeveria, e cila ka bërë të mundur ndërprerjen e një koncesioni që, sipas të gjitha gjasave, do të shërbente në interes të drejtuesve aktualë të Bashkisë, që e dinin se nuk kishin perspektivë në këtë aktivitet. Në rastin e Elbasanit, drejtuesit aktualë, që janë rikandiduar, u tërhoqën nga objektivi i tyre për të mos rrezikuar. Ndërkohë, shefi i opozitës shmangu rrezikimin nga një projekt që do të bëhej lehtësisht antipopullor dhe do të dëmtonte interesin e PD në zgjedhjet lokale.

Por, ajo që mbetet në këtë mes është fakti që bashkiakët në qytetet kryesore në fund të mandatit përpiqen të gjejnë rrugë për të përfituar edhe kur të mos drejtojnë më.




Sfida e Erjon Veliajt synon miratimin e ligjit për hapjen e dosjeve

Komisioni i Ligjeve pritet të miratojnë sot projektligjin e qeverisë

Në javën e fundit si ministër i Mirëqenies Sociale, kandidati i mazhorancës për Bashkinë e Tiranës, Erjon Veliaj ka përballë sfidën për miratimin e projektligjit të propozuar nga ai për hapjen e dosjeve të sigurimit të shtetit. Projektligji i cili do të shqyrtohet dhe pritet të miratohet sot në Komisionin e Ligjeve. Projektligji i qeverisë synon dhënien e aksesit në dosjet e ish Sigurimit të Shtetit sipas një procesi të mirë-rregulluar për të gjithë personat e prekur drejtpërdrejt nga veprimtaria e ish Sigurimit të Shtetit. Këtu përfshihen jo vetëm personat e përndjekur nga ish Sigurimi, por edhe vetë bashkëpunëtorët dhe ish punonjësit e Sigurimit, të cilët në përputhje me dispozitat e këtij projektligji do të kenë të drejtën e aksesit në plotë në të gjithë informacionin e grumbulluar kundër tyre apo prej tyre gjatë viteve të veprimtarisë së Sigurimit. Akses do të mund të sig-

urohet gjithashtu, për efekt të veprimtarisë hulumtuese apo kërkimore me qëllim vlerësimin e veprimtarisë së ish Sigurimit të Shtetit apo vlerësimin të figurës dhe rolit të personave historik të kohës, për aq kohë sa ky

informacion i shërben qëllimit të deklaruar. Projektligji parashikon informimin e Institucioneve Publike mbi marrëdhëniet që një person, i cili do të promovohet apo emërohet në një pozicion të lartë shtetëror, kushtetues apo publik, ka pasur me ish-Sigurimin e Shtetit, në rast se kërkohet prej tyre, në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të vitit 2010 dhe Opininionin e Komisionit të Venecias. Për të realizuar hapjen e dosjeve projektligji parashikon ngritjen e një komisioni të posaçëm me 5 anëtarë që do trajtojë çdo rast apo kërkesë të ardhur nga individë apo institucionet shtetërore.



Komisioni i Ligjeve

ILDKP

Gjobë 100.000 lekë për 28 zyrtarë që fshehen pasurinë

Inspektoriati i Lartë i Deklarimit të Pasurisë përmes një deklaratë për mediat ka bërë me dije se nga verifikimet për kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, ka evidencuar 28 zyrtarë që nuk kanë përbushur detyrimin ligjor për deklarimin e pasurisë, për të cilët është aplikuar masa administrative dhe gjobë në vlerën 100.000 lekë. ILDKP shpjegon se "në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, nga verifikimi paraprak evidencoi 28 deklaratues, të cilët nuk kanë përbushur këtij detyrim ligjor. Për rrjedhojë, ndaj këtyre subjekteve deklarues, shkelës të detyrimit për deklarim pasurie, Ins-



pektori i Përgjithshëm ka aplikuar masën administrative me gjobë në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë". Gjithashtu, ILDKP u bën thirrje subjekteve që nuk kanë kryer në kohë deklarimin e pasurisë për ta përbushur atë pa vonesë, pasi mosdeklarimi apo refuzimi për të deklaruar interesat private sjell humbje të funksionit publik dhe ndjekje penale, në përputhje me nenin 257/a të Kodit Penal.

» PENSIONET

SIPAS ISSH-S numëri më i lartë i pensioneve të reja ka qënë në Tiranë dhe konkretisht janë lidhur 8.879 pensione pleqërire, invaliditeti dhe familjar




Lidhja

Mesatarja e caktimit të pensionit është 31 ditë. Nga 39.072 pensione të reja, 84% e tyre ose 32.897 pensione janë lidhur brenda afatit ligjor



Vonesat

Arsyet që pensionet nuk lidhen në kohë janë disa, duke filluar që nga mosrespektimi i afateve për verifikimin e pensioneve deri te vonesat e akt-verifikimit të vjetërsisë në punë



Shifrat

Deri në 31 dhjetor 2014 në total ishin 585 mijë e 483 pensionistë, duke shtuar dhe numrin e pensionsitëve të rinj të vonesat e akt-verifikimit të vjetërsisë në punë

AFATET

Fshat dhe qytet, sa lekë marrin 590 mijë pensionistët

Përfitimi për 39 mijë e 72 pensionistët dhe invalidët e rinj

DRICIM ÇAKA
TIRANË

Ndryshimi i skemës për të marrë dhe llogaritur me një formulë të re pensionin e pleqërisë, pensionin e invaliditetit, pensionin familjar dhe atë social, solli dhe rritjen e përfitimit. Deri në 31 dhjetor 2014, pensionet që u lidhën për të gjithë të moshuarit u caktuan me formulën e vjetër e cila, kufizonte përfitimet, ndërsa nga 1 janari 2015, formula P=PS+SH, të jep mundësinë të marrësh një pension bazë prej 6750 lekë dhe për çdo vit kontribut që derdhet, rritet pensioni. Por si janë caktuar pensionet deri tani? Nga të dhënat që gazeta ka siguruar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, deri në 1 janar 2015 janë caktuar 39 mijë e 72 pensione gjatë viti 2014, numër më i lartë se vitet e kaluara. Lidhur me afatin që janë caktuar pensionet, ISSH thotë se shumica e tyre janë lidhur brenda 45 ditëve, ndërsa një pjesë janë lidhur jashtë afatit për shkak të vonesave të shqyrtimit të dokumentacionit nga vet inspektorët në drejtoritë rajonale. "Mesatarja kombëtare e caktimit të pensionit është 31 ditë nga 45 ditë që është përcaktimi ligjor. Nga 39.072 pensione të reja, 84% e tyre ose 32.897 pensione janë lidhur brenda afatit ligjor dhe koha mesatare e caktimit të tyre është 21 ditë. Pjesa tjetër, rreth 16% janë lidhur jashtë afatit ligjor dhe janë mesatarisht për 85 ditë. Numëri gjithësej i pensioneve të reja është 29.966, numri i pensioneve të invaliditetit është 6.491 dhe numri i pensioneve të reja familjare është 2.615. Arsytet që pensionet nuk lidhen në kohë janë disa, duke filluar që nga mosrespektimi i afateve për verifikimin e

Numëri i pensioneve të reja deri në 01.01.2015

	PENSION TOTAL		PLEQËRIE		INVALIDITETI		FAMILJAR		Total
	Urban	Rural	Urban	Rural	Urban	Rural	Urban	Rural	
■ Berat	1.725	163	1.449	112	195	34	81	17	1.888
■ Dibër	1.051	216	802	175	147	26	102	15	1.267
■ Durrës	3.400	458	2.480	312	663	109	257	37	3.858
■ Elbasan	3.514	497	2.457	328	834	117	223	52	4.011
■ Fier	4.050	518	3.375	325	465	133	210	60	4.568
■ Gjirokastrë	1.222	110	1.023	90	133	15	66	5	1.332
■ Korçë	3.883	360	2.953	244	702	88	228	28	4.243
■ Kukës	542	109	325	101	144	6	73	2	651
■ Lezhë	1.520	232	1.079	168	322	48	119	16	1.752
■ Shkodër	2.637	329	2.125	230	339	78	173	21	2.966
■ Tiranë	8.237	642	6.396	473	1.279	114	562	55	8.879
■ Vlorë	3.367	290	2.742	202	427	73	198	15	3.657
Total	33.148	3.924	27.206	3.700	5.630	841	2.292	323	39.072

Pensionistë në vite

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	gjendja në fund 2014
Pensionistë urbanë	374,838	380,852	384,187	390,956	399,959	418,399	436,337
pleqërie	283,584	285,630	285,875	288,533	296,076	311,382	327,604
invaliditeti	41,534	45,146	48,402	52,023	55,245	59,241	61,200
familjarë	49,720	50,076	49,910	50,400	48,638	47,776	47,533
Pensionistë ruralë	159,433	159,570	158,866	157,719	154,143	152,024	149,146
pleqërie	142,863	142,742	142,015	140,776	137,771	135,904	133,132
invaliditeti	5,454	5,942	6,375	6,662	6,853	7,229	7,579
familjarë	11,116	10,886	10,476	10,281	9,519	8,891	8,435

pensioneve deri te vonesat e akt-verifikimit të vjetërsisë në punë, brenda Drejtorive Rajonale të ISSH-s dhe sidomos kthimi i përgjigjeve nga drejtoritë e tjera", - përcakton dokumenti i ISSH për pensionet. Sipas ISSH deri në 31 dhjetor 2014 në total ishin 585 mijë e 483 pensionistë, por duke shtuar dhe numrin e pensionsitëve të rinj për 2015, do të jenë rreth 589 mijë e 750 të moshuar që do të marrin pension.

TË REJA

Sipas tabelës së ISSH numëri më i lartë i pensioneve të reja ka qënë në Tiranë dhe konkretisht janë lidhur 8.879 pensione pleqërire, invaliditeti dhe familjar. Numëri më i madhë i pensioneve që janë lidhur është në qytet, rreth 8-fishi më i lartë krahasuar me fshatin.

Pensione në total, në qytet për vitin 2014 janë lidhur 33.148, ndërsa në fshat janë

lidhur 3.924.

Pensione pleqërie për një vit janë lidhur 27.206 në qytet dhe 3700 në fshat.

rej deri në 1 janar 2015, ditë kur hyri në fuqi dhe formula e re e pensioneve. Duhet theksuar se 585 mijë e 483

DIFERENCA

"Shifrat e ulta në fshat vijnë për shkak se shumë të moshuar zgjedhin të dalin në pension para kohe si dhe u është lidhur pensioni i reduktuar"

PËRFITIMI

Gjithashtu ISSH ka llogaritur dhe përfitimet, sa mer-

pensionistët që kanë marrë pension me ligjin e vjetër, nuk janë objekt i formulës së


re dhe përfitimet e tyre janë sipas tabelës të mëposhtme. Pensioni mesatar mujor sipas ISSH në qytet është 14 mijë e 70 lekë, ndërsa në fshat është 7 mijë e 300 lekë.

Shifrat e ulta në fshat vijnë për shkak se shumë të moshuar zgjedhin të dalin në pension para kohe si dhe u është lidhur pensioni i reduktuar, duke qënë se nuk kanë plotësuar vitet e mjaftueshme për pension të plotë.

Kontributet

Ligi për të vetpunësuarit në buqësi

— Ligji nr.15/2014, datë 18.11.2014 "Për faljen e kamatëve vonesave dhe gjobave për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të papaguara nga personat e vetpunësuar në buqësi", shtriu efektet deri në datë 31.12.2014 dhe influencën, në rritjen e numrit të fermerëve të siguruar. Gjatë 2014-s, derdhën kontribute 882 mijë persona. Po kështu është vërejtur një ulje e numrit të invalidëve të rinj. "Riorganizimi i KMCAP-eve të Drejtorive Rajonale të ISSH, solli rinovimin e 61 anëtarëve. Kontrolli i ushtruar në disa drejtori për kriteret mjekësore, për ndërhyrje të veçanta, ka ushtruar ndikimin e vet në uljen e numrit të invaliditetit, pasi u zbatuan kriteret mjekësore dhe u rikontrolluan", - thotë ISSH.





Erion Veliaj:

Ndryshimi në skemë, solli rritjen e pensioneve

— Formula e re e pensioneve u ndryshua falë iniciativës së ministrit të Mirëqenies Sociale Erion Veliaj, i cili foli për ndryshimin e skemës që në momentin kur mori mandatin e ministrit. Për Veliajin skema e re solli një rritje të pensioneve nga 2-40%. "Formula është e tillë që i ka rritur pensionet nga 2% deri në 40%, për ata që dalin në pension me këtë reformë të re. Qytetarët të cilët kanë punuar 41-42 vjet, ish-ushtarakë, teknologë, inxhinierë, kanë shkuar në shtëpi sot me pensione 340, 345, 350 mijë lekë. Një pension nga 240 në 345 mijë lekë është mbi 40%

më i lartë. Ne inkurajojmë qytetarët të bëjnë garë kush del i pari. Ai që realisht ka 41-42 vjet punë nuk mund të rrijë të geto 240 mijë lekë dhe sigurisht do të marrë një pension më të lartë dhe sot e ka një pension më të lartë", - u shpreh Veliaj pak kohë më parë. Gjithashtu ministri Veliaj muajt e kaluar premtoi një tjetër rritje të pensioneve brenda 6-mujorit të parë të 2015-s, pas rritjes që u bë një vit më parë me vendim qeverie. Ligji i ndryshuar për pensionet, kishte si qëllim parësor që të mos linë asnjë të moshuar pa ta ardhura, dhe kjo sigurohet falë pensionit social, i cili përfitohet në moshën 70-vjeçare.



Llogaritja



DRIÇIM ÇAKA
TIRANE

Pensionistët e rinj, shumica që marrin në tre raste

Shuma që përfitohet për pagat, 30.000, 40.000 e 50.000 lekë

Specialistët e Insitutit të Sigurimeve Shoqërore, shpjegojnë për gazetën sa lekë marrin sot pensionistët e rinj. "Baza e llogaritjes së pensionit është 6 750 lekë që është pensioni social. Për llogaritjen e pensionit të pleqërisë, merret shumica e mësipërme dhe i shtohen 1% e pagës mesatare të çdo viti. Pra nëse një person ka punuar me pagë 30.000 lekë gjatë një viti, 6 750 lekëve i shtohet dhe 300 lekë dhe pensioni shkon 7 050 lekë. Kjo do të thotë që nëse ke 35 vite punë me pagë 30 000 lekë atëherë, llogaritja nga vitet e kontributeve del 10 500 lekë, (1% e 30.000 lekëve është 300 lekë. $35 \cdot 3 = 10.500$ lekë) duke i shtuar dhe 67 500 lekë, që është pensioni social, shumica që përfitohet është 16 800 lekë. Gjithmonë nëse je me pagë 30.000 lekë për të gjitha vitet, pasi nëse gjatë disa viteve të caktuara ke patur një pagë më të lartë, atëherë 1% llogaritet mbi pagën reale dhe përfitimti është akoma më i lartë" - thonë drejtuesit e ISSH-s. Këtë përfitim ekspertët e ISSH e lidhin dhe përcaktimin e nenit 59 për ligjin "Për sigurimet shoqërore", i cili thotë se: Për efekt të llogaritjes së pensioneve me datë fillimi pas 1.1.2015 e në vazhdim, baza e vlerësuar mesatare do të llogaritet bazuar në pagat

Të ardhurat për pension pleqërie (pa kompensimet)

Masa e përfitimt	Urban	Rural
Masa e pensionit	Lekë në muaj	Lekë në muaj
■ Minimal	12.264	8.398
■ Mesatar i plotë	15.867	8.064
■ Mesatar	14.710	7.381
■ Maksimal	24.528	12.264

MASA E TË ARDHURAVE NGA PENSIONI

■ Minimale	14.414	9.288
■ Mesatar i plotë	17.423	8.644
■ Mesatare	16.266	7.961
■ Maksimale	25.028	12.464

Të ardhurat mujore të pensionistëve

Lloji i pensionit	Pensioni mesatar mujor	Të ardhurat mesatare mujore
PENSIONE URBANE		
■ pensione pleqërie	14,710	16,266
■ pensione invaliditeti	12,593	14,150
■ pensione familjare	6,765	8,321
■ të plota pleqërie	15,867	17,424
PENSIONE RURALE		
■ pensione pleqërie	7,381	7,961
■ pensione invaliditeti	6,113	6,693
■ pensione familjare	3,252	3,832
■ të plota pleqërie	8,064	8,644



referuese, sipas llojit të punës ose funksionit përpara datës 1.1.1994, si edhe mbi pagat individuale, mbi të cilat janë paguar kontributet sipas viteve, nga 1.1.1994 deri në 31.12.2014, të indeksuara me indeksin që del nga pjesëtimi i pagës minimale në shkallë vendi të vitit 2014 me pagën minimale të vitit 1994 ose me pagën minimale të vitit përkatës.

RASTET

Për një pagë 40.000 lekë për 35 vite kontribute, pensioni llogaritet në këtë mënyrë: 6.750 lekë pensioni social, plus 14.000 lekë, shumica nga llogaritja e kontributeve të

derdhura ($1\% \text{ e } 40.000 = 400 / 35 \cdot 400 = 14.000 / 6750 + 14.000 = 20.075$ lekë) dhe në total përfitohet 20.075 lekë. E njëjta mënyrë vepron dhe për një pagë prej 50.000 lekë. 35 vite kontribute shumzohen me 500 lekë për çdo vit (1% e 50.000) dhe shkojnë 17.500 lekë. Kësaj shifre i shtohet dhe pensioni social 6.750 lekë dhe pensioni total shkon 24.250 lekë. Për të vetpunësuarit në buqësi pensioni llogaritet mbi bazën e kontributeve që janë derdhur, pra mbi pagat minimale të cilat kanë paguar kontributet. E njëjta mënyrë vlen dhe për ata që kanë punuar në ish-kooperativat bujqësore.

NDRYSHIMI

Çfarë përcakton formula e re e pensioneve

— Formula e re për llogaritjen e pensioneve është $P = PS + Sh$, ku: P është masa e pensionit mujor PS është pensioni social, që kap një vlerë prej 6750 lekë, pra masa e të cilit është jo më e lartë se masa e pensionit të pjesshëm dhe Sh është shtesa, vlera e së cilës është 1% e vlerës së bazës së vlerësueshme për çdo vit, e cila përfaqëson raportin e kontributeve mesatare në vitin aktual, me kontributet mesatare të viteve të mëparshme. Ndërsa me skemën e vjetër pensioni mujor përbëhej nga një shumë bazë dhe nga një shtesë, por që kufizonte përfitimet.

Ministri i Shëndetësisë: Vaksinat kontrollohet nga mjekët dhe shkencëtarë

Beqaj: Prindërit përgjegjësi të vaksinohet fëmijët

Arsyet pse duhet të vaksinohen fëmijët: Mbrojnë nga sëmundjet

DRIÇIM ÇAKA
TIRANE

Vaksinimi është një e drejtë themelore e fëmijëve, dhe si e tillë, prindërit kanë përgjegjësinë ta realizojnë atë ndërsa institucionet e sistemit të kujdesit shëndetësor kanë detyrimin t'ua ofrojnë dhe të krijojnë kushtet që ky shërbim të ofrohet kudo dhe të jetë i sigurt, pavarësisht kushteve social-ekonomike dhe venbanimit të tyre. Kështu u shpreh ministri i Shëndetësisë Ilir Beqaj në ditën e Javës Evropiane të Vaksinimit, 20 prillin. "Ashtu siç jemi angazhuar në Programin Qeverisës, se do t'u japim qytetarëve mbrojtjen e merituar përmes një sistemi shëndetësor me mbulim dhe akses universal, qëllimi ynë është të ofrojmë shërbime bazë cilësore si vaksinimi i të gjithëve, me qëllim që të mos kemi pabarazi në përhapjen e sëmundjeve infektive. Të gjitha vendet e rajonit i kushtojnë një rëndësi të veçantë vaksinimit dhe kemi mbulesa të larta vaksinale në popullatën e përgjithshme. Në vendin tonë, kjo mbulesë është mbi 97% për çdo vaksinë të kalendarit kombëtar në çdo komunitet anëkdorë territorit të Republikës këto dy vitet e fundit", - thekësoi Beqaj gjatë konferencës të organizuar në mjediset e Ministrisë së Shëndetësisë.



VAKSINAT

Kontrolli

"Vaksinimi është i sigurt dhe efektiv. Të gjitha vaksinat kalojnë një proces të gjatë vlerësimi nga shkencëtarë, mjekë dhe autoritete kontrolli"

Sëmundjet

"Sëmundjet e parandalueshme me vaksinë të tilla si Fruthi, Shytat dhe Kolla e Mirë, janë ende një kërcënim. Këto sëmundje infektive shumë lehtë fëmijët"

Ministri

Të gjitha vendet e rajonit i kushtojnë rëndësi të veçantë vaksinimit. Në vendin tonë, kjo mbulesë është mbi 97% për çdo vaksinë të kalendarit kombëtar



Ilir Beqaj në konferencën për javën europiane të vaksinimit

fundit', - thekësoi Beqaj gjatë konferencës të organizuar në mjediset e Ministrisë së Shëndetësisë.

ARSYET

Ministri i Shëndetësisë renditi dhe arsyet pse duhet

të vaksinohen fëmijët. "Sëmundjet e parandalueshme me vaksinë të tilla si Fruthi, Shytat dhe Kolla e Mirë, janë ende një kërcënim. Shytat dhe Kolla e Mirë ende qarkullojnë në vendin tonë, ndërsa Fruthi qarkullon në

vendet fqinje me ne. Këto sëmundje infektive shumë lehtë fëmijët duke çuar dhe në shtrimin e tyre në spitale. Shpërthimet epidemike nga sëmundjet e parandalueshme me vaksinim ndodhin atëhere kur shumë prindër vendosin

të mos i vaksinonin fëmijët e tyre. Vaksinimi është i sigurt dhe efektiv. Të gjitha vaksinat kalojnë një proces të gjatë vlerësimi nga shkencëtarë, mjekë dhe autoritete kontrolli, në mënyrë që të garantohet siguria e tyre", - tha Beqaj.

PRESIDENTI

Nishani nuk e largon Rektorin Mitat Mema



Fakti se Rektori Mitat Mema mbajti të mbyllur në zyrë dekanin Elmas Leci, duke mos e lejuar të dalë për 8 orë rresht në ditë, nuk është arsye sipas Presidentit të Republikës Bujar Nishani, për të larguar nga puna. Në përgjigjen kthyer ministres Lindita Nikolla Presidenti thotë se ky veprim është bërë për të marrë nën kontroll Universitetin dhe sipas tij nuk janë dorëzuar fakte që të tregojnë se Rektori ka shkelur ligjin. Presidenti thekson se mund të largojë Rektorin vetëm në rastet kur ka shkelur ligjin për asrimin ose ka abuzuar me detyrën. Ministria Lindita Nikolla gjatë një kontrolli në muajin mars, zbuloi skandalin ku mbahet i mbyllur dekan Elmas Leci. Ministria pezulloi Rektori, por largimi është e drejtë vetëm e Presidentit të Republikës.

PROCESI

Ricertifikimi i farmacistëve, ja dokumentat që duhen

Afati deri në 30 prill për të dorëzuar dokumentat, për farmacistët

Urdhëri i Farmacistëve ka publikuar dokumentat që duhen për të procesin e ricertifikimit, në të kundërt, farmacistët do kalojnë në provim ricertifikimi. "Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë është në prag të nisjes së procesit të ricertifikimit të farmacistëve anëtarë të Urdhrit. Jemi akoma në pritje të listave përfundimtare të krediteve për secilin farmacist nga QKEV, pasi procesi i recertifikimit nuk mund të nisë pa këto lista", - thotë në një njoftim Urdhëri i Farmacistëve. Dokumentat që duhet të dorëzohen deri në 30 prill: 3 fotografi të përmasave 3x3,5 cm. Ekstraktin historik të QKR-së të 3 muajve të fundit. Fotokopjen e licencës së QKL-së. Fotokopjen e kartës së identitetit Mandatin e pagesës së kuotizacioneve ndaj UFSH-së deri më 30.06.2015. Mandatin e pagesës për rinovimin e Lejes së Ushtrimit të Profesionit me vlerë 5 000 lekë, bazuar në Vendimin nr.4, dt 03.12.2014. Certifikata e Anëtarësimit origjinale do të dorëzohet nga vetë personi në momentin e tërheqjes së Certifikatës së pranë zyrave qendrore të UFSH-



së sipas një lajmerimi të tyre.

PROVIMI

Për ata farmacistë që nuk plotësojnë numrin e kërkuar të krediteve do të kalojnë në provim ricertifikimi. "Provimi i ricertifikimit kryhet për të vlerësuar nivelin e njohurive dhe kompetencave të profesionistëve që nuk janë angazhuar plotësisht në edukimin e tyre në vazhdim gjatë një cikli ricertifikimi dhe për të garantuar përpunjen me kërkesat bashkëkohore të praktikës profesionale. Përmbajtja e provimit hartohet nga Komisioni i Provimit të Ricertifikimit në përpunjen me fushën e veprimtarisë profesionale dhe me zhvillimet e reja shkencore në këtë fushë. UMSH, UFSH dhe USSH është përgjegjës për pezullimin e lejes së ushtrimit të profesionit të gjithë atyre profesionistëve të cilët në përfundim të ciklit të ricertifikimit kanë 0 kredite dhe atyre që nuk e kanë kryer me sukses provimin e ricertifikimit në përfundim të periudhës 6 mujore në dispozicion", - përcaktonte udhëzimi për provimin e farmacistëve.

Dosja



ELTON QYNO
TIRANE

Sekseri në çdo datë 15, paguante lekët tek hetimori Metjon Bijo

Kontrolli në karburant, "do përpiqem ta kaloj, unë kam aq mundësi sa për të mbuluar gjurmët"


Çdo mesmuaji, kur data shënonte "15" punonjësi i bashkisë së Tiranës Kreshnik Kasaj, telefonote specialistit e hetimit të Drejtorisë së Tatim-Taksave Metjon Bijo, të cilit i paguante shumën e parave që kishte mbledhur në biznese të ndryshme. Një fakt i tillë është evidentuar në 15 prill 2015 ku sekseri Kreshnik Kasaj, ka telefonuar shtetasin Metjon Bijo, duke i kërkuar ta takojë. Nga hetimi kanë rezultuar dyshime se çdo mes muaji shtetasi Kreshnik Kasaj i dorëzon shtetasit Metjon Bijo "kuoten" mujore për "mbrojtjen" që ky i fundit i bën nga hetimi tatimor. Kështu më datë 15.04.2015 shtetasi Kreshnik Kasaj ka shkuar në lokalit e administruar nga Metjon Bijo dhe i ka lënë kamarierit të lokalit shumën 99.000 lek, fakt i cili ka rezultuar dhe nga përgjimi telefonik. Më pas shtetasi Metjon Bijo ka shkuar në lokal dhe ka marrë shumën e lënë nga Kreshniku. Në këtë moment ka ndërhyrë policia gjyqësore e cila ka arrestuar në flagrancë shtetasin Metjon Bijo për veprën penale të "korruptionit pasiv të personave që ushtrionin funksione publike".

KONTROLLE NË KARBURANTE

Në dosjen e njësisë hetimore Task-Forcë, thuhet se një grup kontrolli nga Drejtoria e Tatimeve përgjatë periudhës nga data nga 12.01.2015 deri 16.01.2015 ka ushtruar kontroll në pikat e karburanteve në disa akse të rrugëve të Qarkut

VIDEO/ KONTROLLET SELEKTIVE NË BIZNESE

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të AIREPORT që shkarkohet falas



Shkodër. Ky grup kontrolli kryesohet nga shtetasi Mensur Hoxha. Nga process-verbalet e transkriptimit të bisedave ka rezultuar se shtetasi Mensur Hoxha në mospërbushje të rregullt të detyrës kërkon të favorizojë subjektet, të cilët shesin karburant pa qenë të licensuar, pa kasë fiskale dhe pa asnjë dokumentacion për blerjen e mallit, subjekte të cilat dyshohet se tregtojnë karburant kontrabandë.

"DO PËRPIQEM TA KALOJ"

Më konkretisht gjatë

bisedës që Mensuri zhvillon me një subjekt që tregon karburant pa dokumentacion, ndër të tjera i thotë: "Do përpiqem ta kaloj". Më pas gjatë bisedës së zhvilluar Mensur i premtom se do ta kaloj praktikën këtë rradhë, pasi i ka aq mundësi për të mbuluar gjurmët. Nga përgjimi rezultom se inspektori Mensur Hoxha ka komunikuar në telefon me një shtetas të identifikuar

me emrin Valjon. Nga biseda konstatohet se grupi i kontrollit ka ushtruar kontroll tek karburanti që administrohet nga Valjoni dhe nga biseda rezultom se për ushtrimin e këtij aktiviteti Valjoni nuk zotëron "Nipt sekondar". Në aktin e konstatimit të mbajtur nga shtetasit Mensur Hoxha, Metjon Bijo, Trandafil Tarja etj evidentohet se karburanti është i mbyllur dhe nga grupi nuk është arritur të kontak-

VENDIMI
Gjykata mbyll në burg 5 inspektorë



Gjykata e Tiranës me kërkesë të prokurorisë ka caktuar masën e sigurisë "arres me burg" për 5 të arrestuarit dhe 3 të shpallurit në kërkim. Tre të dyshuarit e tjerë është caktuar masa e "Arrestit shtëpiak", ndërsa për dy të dyshuarit që ishin pjesë e këtyre grupeve u caktua masa e sigurisë "detyrim për paraqitje" për arsye shëndetësore. Kasaj rezultom se ka paguar para edhe për të kontrolluar nga tatimet dhe mbyllur pika bastesh apo dyqane të lojave të fatit të cilat ishin konkurent. Ndërsa me ndërmjetësimin e Petrit Ahmetaj, i arrestuarit Kasaj paguante inspektorët e Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojave të Fatit që drejtoheshin nga përgjegjësi Jani Berukasi për të vazhduar aktivitetin e biznesve të lojave të fatit edhe pa licencë.

tohet më ndonjë person. Ky fakt është në kundërshtim me transkriptimet e bisedës telefonike të kryer ndërmjet shtetasit Mensur Hoxha dhe subjektit kundravajtës. Pra në këtë akt-konstatimi janë pasqyruar fakte të reme.

LAJME
shkurt



KLD, verifikon pafajësinë e Arben Frrokut

Vendimi i pafajësisë që pesë gjyqtarët kryesuar nga Dritan Halunaj, dhanë për biznesmenin Arben Frrokut të dyshuar për vrasjen e kryekomisarit Dritan Lamaj, do të inspektohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Kjo konfirmohet nga Prokuroria e Përgjithshme, e cila pak ditë më parë depozitoi në KLD një ankesë për vendimin e gjyqtarëve të cilët më 3 prill e shpallën Frrokut të pafajshëm. Sipas Prokurorisë së Përgjithshme, KLD nëpërmjet Inspektoriatit i ka kthyer përgjigje organit të akuzës, se "nga analiza e pretendimeve të parashtruara ka konkluduar se ka vend për verifikimin e ankesës".



Fier, i kafshoi veshin shokut, arrestohet

Një 26 vjeçar ka rënë në prangat e policisë së Fierit, teksa pas një sherrri me një bashkëfshatar të tjiin i ka ngrënë veshin këtij të fundit. I arrestuari është Malvin Troka, ndërsa sipas bluve të Fierit ngjarja ka ndodhur pas një sherrri të dhunshëm. I lënduari identiteti i të cilit ende nuk dihet është dërguar në spitalin e Fierit. Ndërkohe lidhur me këtë sherr në pranga ka rënë edhe një 16 vjeçar pasi ka goditur me thikë një 52 vjeçar.

Apeli në Shkodër, burg përjetë dy vëllezërve Përmarkaj për vrasje

Në 2012 Përmarkajt qëlluan mbi familjen Markaj në Pukë

Vendimi
TIRANE

Gjykata e Apelit ka vendosur të mos ndryshojë dënimin për tre vëllezërit Përmarkaj nga Puka dhe kushëririn e tyre, nën akuzën e vrasjes së dy personave dhe plagosjen e tre të tjerëve për motive pronësie në vitin 2012. Apeli i Shkodrës la në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë e cila dënoi me burgim të përjetshëm dy vëllezërit Anton dhe Sokol Përmarkaj, vëllai tjetër i tyre Bardhoku u dënua me 22 vjet ndërsa kushëriri Fran (seferin) Përmarkaj me 24 vjet heqje lirie. Ishte pala mbrojtëse e cila kishte bërë animimin, por Gjykata e Apelit e rrëzoi këtë kërkesë duke mbështetur



akuzat e prokurorisë. Ngjarja e rëndë u shënua më 29 Qershor të 2012-ës në fshatin Qelëz të Pukës, ku katër të dënuarit në bashkëpunim me njëri-tjetrin i zunë pritë dhe qëlluan me armë zjarri në drejtim të anëtarëve të familjes Markaj, të cilët udhëtonin në autobus. Nga të shtënat humbën jetën Paulin dhe Hilë Markaj, si edhe u plagosën Tone Markaj, Angelina Markaj dhe Alfons Markaj. Konflikti ndërmjet fëmijëve Përmarkaj dhe Markaj kishte nisur disa kohë më parë se të ndodhte ngjarja kriminale, për

shkak të një toke që i ishte lënë në përdorim familjes së të pandehurve. Menjëherë pas krimit të rëndë autorët janë larguar me shpejtësi në pyll, ku njëri prej tyre është arrestuar, ndërkohë Sokol Përmarkaj ka mundur ti shmanget prangave të policisë së shtetit. Sokol Përmarkaj është arrestuar një vit më vonë në Athinë, dhe më pas është ekstraduar në Shqipëri, ku dhe i është nënshtuar procesit gjyqësor. Në gjykatën e Apelit Shkodër, çështja është mbrojtur nga prokurori Elvin Gogaj.

Emigracioni



Deputetja italiane: T'i mbysim skafet siç bëmë me shqiptarët

Deklaratë shokuese e Daniela Santanche, pas tragjedis

Duhet t'i mbysim anijet siç bëmë me Shqipërinë. Nuk ka zgjidhje tjetër. Më mirë një akt lufte, sesa ta humbim luftën". Kjo është deklarata shokuese e Daniela Santanche, deputetes së 'Forza Italia', një ditë pas tragjedisë në kanal in e Sicilisë ku humbën jetën mbi 700 emigrantë. Santanche që është dhe krahu i djathtë i ish kryeministrit Silvio Berlusconi, ka thënë për televizionin SKY TG24, se Italia duhet të fillojë të aplikojë një strategji vetëm-brojtëse. "Nuk është tragjedia më e madhe në Mesdhe, por tragjedia e qeverisë italiane, që nuk i përballet në mënyrën e duhur problemit. Nuk ka kohë për të pritur, duhet të çohet marina jonë për të përmbytur të gjitha anijet, siç ka ndodhur në Shqipëri. Nëse më pas kjo është një veprim lufte apo nuk është, pak rëndësi ka. Më mirë një akt lufte, sesa të humbim



Pamje nga tragjedia e pardjeshme



Daniela Santanche

drejt Italisë me një anije të vjetër ushtarake, të nxjerrë jashtë përdorimit. Edhe në atë kohë një deputete italiane, Irene Pivetti, u shpreh njësoj, se për të përballuar mbërritjen e mijëra shqiptarëve, ata duheshin hedhur në det.

DËSHMIA PËR TRAGJEDINË NË MESDHE

Fakte tronditëse po dalin pas mbytes së peshkarexhës në kanal in e Sicilisë. "Në bord ishim 950 persona. Kishte 50 fëmijë dhe 200 femra". Kjo është deklarata që ka dhënë në Prokurorinë e Katania një i mbijetuar i mbytes së peshkarexhës që çoi në vdekjen e rreth 700 personave. Burri nga Bangladeshi ka shtuar se shumë nga klandestinët ishin mbyllur në nivelet e poshtme të mjetit lundruar dhe nuk lejoreshin të dilnin nga trafikantët.

luftën. Zgjidhja e vetme është që të përmbysim anijet, që të mos nisen më. Kjo dëshira për t'i shpëtuar të gjithë, në fund na i lyen duart me gjak. Kjo është e vetmja mënyrë

që mund të bëhet. Janë lot krokodili të atyre që thonë se është një tragjedi e vërtetë, tragjedia e vetme është e qeverisë sonë", deklaroi deputetja Daniela Santanche.

Më 28 mars të 1997-ës duke ndjekur të njëjtën taktikë mbrojtëse, anija ushtarake italiane "Sibila" goditi dhe shkaktoi fundosjen e anijes shqiptare "Kater i Radës"

me 120 pasagjerë që po lundronte në bord në Kanal in e Otrantos. Bilanci i tragjedisë së Otrantos shënoi 108 viktime, përfshirë gra dhe fëmijë, të cilët udhëtonin



AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM

PËR ÇELJEN E PROCEDURËS TË DHËNIES SË 5 LICENCEVE PRIVATE KOMBËTARE TRANSMETIMI AUDIOVIZIV NUMERIK, SIPAS BEAUTY CONTEST

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", rregullores "Për licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve të tyre, nëpërmjet procedurës së **beauty contest**" miratuar me vendimin nr. 28, datë 16.04.2015 të AMA-s dhe vendimit nr. 29, datë 16.04.2015 të AMA-s "Për çeljen e procedurës së dhënies të 5 licenceve private kombëtare transmetimi audioviziv numerik sipas **beauty contest**", në muajin Maj 2015, do të organizojë procedurën e përzgjedhjes së kandidaturave për dhënien e 5 licenceve private kombëtare transmetimi audioviziv numerik të përbëra nga:

1. Licenca të shërbimit të programeve të veta audiovizive dhe
2. Licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit tokësor, për ndërtimin e vënien në funksionim të 5 rrjeteve numerike tokësore kombëtare në brezat e frekuencave 470-790 MHz me gjerësi brezi 8 MHz, në teknologjinë DVBT-2, me standardin e kompresionit MPEG-4.

Subjektet, shoqëria "Tv Klan" sh.a., shoqëria "Top Channel" sh.a., shoqëria "Digit-Alb" sh.a., shoqëria "Supersport" sh.a. dhe shoqëria "Tring TV" sh.a., të përcaktuar nga AMA si operatorë historikë privatë kombëtarë dhe me eksperiencë në transmetimet numerike, sipas vendimit nr. 29, datë 16.04.2015, janë të lutur që të paraqiten në Autoritetin e Mediave Audiovizive në datën 23.04.2015, ora 10.00, për të marrë pjesë në procedurën e shortit që do të organizohet nga Komisioni i Beauty Contest-it për tërheqjen e dokumentacionit të licencimit sipas procedurës së **beauty contest**. Mosparaqitja në procedurën e zhvillimit të shortit për tërheqjen e dokumentacionit të licencimit sjell skualifikimin e subjekteve nga procedura e licencimit.

Dokumentacioni i licencimit përfshin:

- Rregulloren "Për licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve të tyre, nëpërmjet procedurës së **beauty contest**";
- Formularin e aplikimit;
- Karakteristikat teknike të rrjeteve numerike dhe planin e frekuencave numerike;
- Pagesën vjetore për licencë, taksat për shërbimet rtv etj, të llogaritura për zonën e licencimit.

Dokumentacioni do të tërhiqet pas kryerjes së pagesës prej 1.000 (njëmijë) lekë në Drejtorinë Ekonomike të AMA-s.

Aplikimet do të hapen në datën 27.05.2015, ora 10.00, në mjediset e AMA-s, ku aplikuesit apo përfaqësuesit e autorizuar prej tyre, kanë të drejtë të jenë të pranishëm në momentin e hapjes së dosjeve të aplikimit.

EMIGRACIONI infekton edhe rajonin juglindor. Dhjetëra qytetarë mësohet se janë nisur drejt perëndimit me shpresën se do përfitojnë azil ekonomik



Dano

"Në Gjermani shkova përmes Italisë. Ishte shumë e vështirë për të përfutur azil. Edhe shokët me të cilët mbaj kontakt kanë bërë kërkesë për t'u kthyer"



Memet Dano

Largimet

200

Familje në Korçë
Vetëm në këtë qytet, në një hark kohor të tre muajve të fundit janë larguar rreth 200 familje në drejtim të kampeve të azilantëve në Gjermani

150

Familje në Dukat
Në një hark kohor prej 6 muajsh, në fshatin Dukat të Vlorës, mësohet se janë larguar rreth 150 familje, me idenë se do të përfitojnë azil ekonomik

Shpresa për azil, rradhë në sportele

I kthyeri nga Gjermania: Ishte e pamundur ta përfitoja

XHENSILA KODRA
VLORE

Numri i shqiptarëve të cilët po kërkojnë azil në vendet e BE-së sa vjen e po shtohet nga dita në ditë. Dhjetëra qytetarë dynden në zyrat e gjendjes civile në qytetin e Fierit të cilët mbajnë rradhë për të marrjen e pasaportave, çertifikata personale apo edhe atyre familjare familjare, si edhe dokumente të tjera me

procedura të përshpejtuara. Në këtë qytet, banorë të zonave të ndryshme paraqiten në këto zyra që prej orës 4 të mëngjesit, për të mbajtur radhën pranë sporteleve të aplikimit për marrjen e dokumentacioneve të fëmijëve apo edhe të të afërmeve të tyre. Ndërkohë, kreu i njësisë nr. 2 në Bashkinë e Fierit, Maksim Zarka, shpreh se në të gjithë zyrat e aplikimit ka dyndje të madhe të popullsisë. Sipas tij, shumë nxënës janë larguar nga shkolla duke ulur numrin e tyre në këto ambiente. "Është

Brataj
"Vështirësitë financiare janë ato që i detyruan banorët të marrin rugën drejt Perëndimit duke shpresuar për azil"

një numër shumë i madh i banorëve të cilët kërkojnë të nxjerrin pasaportat për veten e tyre, për fëmijët apo edhe për

të afërmit e tyre. Kjo situatë, në këtë qytet ka rreth dy javë, ku një numër i madh i qytetarëve mbajnë rrdhë në sportele që në orën 4 të mëngjesit", ka shprehur Zarka. Po ashtu, në qarkun e Fierit, fshatrat e Cakranit, Libofshës dhe shumë të tjerë kanë pasur një lëvizje masive të banorëve drejt Gjermanisë duke braktisur çdo gjë të ndërtuar më parë në vendin e tyre. Gjithashtu, ndër më të prekurit nga vala e emigracionit drejt vendeve të BE-së janë edhe fshatrat Tragjas dhe Dukat, në Vlorë. Shumë prej të rinjve të këtyre zonave kanë braktisur vendin e tyre dhe janë nisur drejt Gjermanisë me shpresën se do të përfitojnë azil. Ndërkohë, deri më tani mësohet se askush nuk ka mundur të përfitojë azil, por sërish ata refuzojnë të kthehen në vendet e tyre, përveç të riut Memet Dano, i cili ka gjetur guxim të rikthehet sërish në fshatin e tij, pasi e kuptoi se ishte e pamundur të përfitojë azil.

Dano sqaron se në Gjermani ka shkuar përmes Italisë, ndërsa rrëfen për A1 Report se u njoftua nga miqtë dhe shokët për punën e azilit, por ajo me të cilën ai u përball atje nuk ishte aspak ajo çka priste. Më tej, Dano shton se është në kontakte të përditshme me shumë shokë të tij, të cilët gjithashtu po kërkojnë të kthehen. Ndërkohë, Kastriot Brataj, kryeplaku i fshatit Tragjas, pohon për A1Report se vështirësitë financiare janë ato që i detyruan banorët të marrin rugën drejt Perëndimit. Gjithashtu, e njëjta situatë paraqitet edhe në fshatin Dukat, teksa shumë të rinj përballë vështirësive ekonomike kanë zgjedhur rrugën e eksodit. Familja e Engjellueshe Celajt

Studimi

Instat, ulja e popullsisë, shkak migracioni neto

Sipas projeksioneve të INSTAT, në vitet 2011-2031, popullsia në Shqipëri në shumicën e qarqeve do të ketë rënie, me përjashtim të Tiranës, Durrësit dhe Vlorës. Numri i banorëve të qarkut të Tiranës parashikohet të rritet më se 25% dhe nga 763.560 banorë në vitin 2011, të arrijë në 965.108 në vitin 2031. Ndërkohë, rritja e popullsisë në dy dekadat që vijnë, parashikohet të jetë shumë më e kufizuar në qarqet e Durrësit dhe të Vlorës, me rreth 3%. Kurse, rënia më e shpejtë e popullsisë pritet të ndodhë në qarqet e Kukësit dhe të Dibërës në veri dhe në Gjirokastrë në jug, ku popullsia pritet të zvogëlohet me rreth 30% deri në vitin 2031. Ndërsa, pjesa tjetër e vendit do të përshihet nga një rënie e popullsisë, nga 10-20% deri në vitin 2031. Gjithcka lidhet me rolin negativ që vijon të luajë migracioni neto në rënie e popullsisë në shkallë vendi. Ndërkohë, të gjithë qarqet e tjera shënojnë një koeficient më të ulët të ndryshimit të popullsisë, ku rezultojnë sipas INSTAT-it, se koeficientin më të ulët të ndryshimit të popullsisë e ka qarku i Gjirokastrës me -2.6%. Vetëm në 2 qarqe, Tirana dhe Durrësi, flukset hyrëse tejkalojnë ato dalëse, duke rezultuar me normë pozitive migracioni, duke vijuar si për gjatë 24 viteve të fundit, të jenë dy qarqet kryesore për migrantët e brendshëm. Qarku i Tiranës ka rritjen më të lartë, mesatarisht me 1.4 % çdo vit në periudhën 2010-2014, ku rreth mbi 10 mijë banorë i shtohen mesatarisht çdo vit në këtë 5-vjeçar. Qarku me rënie më të madhe gjatë 2010-2014 është i Gjirokastrës me 2.7 % mesatarisht çdo vit, ose me terma absolut, ulet me rreth 2 mijë banorë/vit, edhe pse fluksi i migrimit është ulur, krahasuar me periudhën e mëparshme.



New York High School

ditën e shtunë, datë 25 Prill 2015

organizon testin e bursave për vitin shkollor 2015-2016 (ora 10:00 - 12:00)

Testimi konsiston në lëndët Matematikë, Fizikë, Letërsi, Kimi dhe Biologjie do të zhvillohet pranë Universitetit të New Yorkut. Tiranë (adresa: "Kodra e Diellit")
New York High School do të ofrojë bursa të plota (100%) dhe bursa të pjesshme duke vlerësuar rezultatin pas testimit.

Ju lutem na kontaktoni në **044 5 12345**

për çdo pyetje që mund të keni ose na shkruani në **admissions@unyt.edu.al** Faleminderit!

Nxënësit tanë – Fitues të Olimpiadave Kombëtare – Krenaria jonë!



Dittmir Bushati

Dittmir Bushati: Do të gjejmë rrugën e duhur për ta jetësuar Rrëzimi i Byrosë së Hetimit, vonon ligji i policisë

— Rrëzimi i Byrosë Kombëtare të Hetimit nga Gjykata Kushtetuese, ka bërë që Policia e Shtetit të shtyjë vënien në zbatim të ligjit organik të kësaj të fundit. Nisja e vënies në zbatim dhe efektet e tjera që sjell ligji, ishin parashikuar të hynin në fuqi me 22 prill të këtij viti. Por, në këto rrethana, ekspertët dhe juristët e Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit, pritet që të përgatisin amendimet e reja dhe

më pas t'i përcjellin në qeveri dhe në Kuvend. Burime të Policisë së Shtetit thanë se drejtuesit e Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit, kishin përgatitur edhe strukturën e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Madje, pak kohë përpara rrëzimit të ligjit në Kushtetuese, ishin përgatitur edhe propozimet e oficerëve më të mirë të Policisë, për t'u bërë pjesë e kësaj strukture. Kjo pritet të bëjë që njerëzit që ishin përgatitur për këtë strukturë,

të mos lëvizin nga vendet ku ata kryejnë funksionet e tyre në polici tashmë. Nisja e vënies në zbatim të Ligjit të ri të Policisë së Shtetit, pritet të kryhet tashmë pa kapitullin që bën fjalë për ngritjen e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Ministri i Jashtëm, Dittmir Bushati gjatë një interviste për zërin e Amerikës ka theksuar se në respekt të vendimit të Gjykatës Kushtetuese do të gjendet rruga e duhur për jetësimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit.

LAJME shkurt



Pranga të riut për kallëzim të remë

— Një 26-vjeçar është arrestuar nga Policia e Pukës për kallëzim të remë. Burime bëjnë me dije se Edison Kurtaliaj kishte humbur lekët e xhiros në lloton ku punonte dhe pas kësaj telefoni në polici se ishte grabitur dhe ishte lidhur në pisha nga dy persona. Por, policia ka zbardhur të gjithë ngjarjen duke provuar faktin e mashtrimit nga 26-vjeçari, fakt që është pranuar edhe nga ai vetë, pasi ka sekuestruar kompjuterin e punës së 26-vjeçarit, ku rezultonte se ky i fundit kishte vendosur 130.000 lekë bast por e kishte humbur atë.

Arrestohet manjaku seksual që terrorizoi studentet

“Ashiku” plak, veprime perverse te “Qyteti Studenti”

XHENSILA KODRA
TIRANË

Manjaku seksual i cili prej disa kohësh ishte kthyer në një makt për disa prej studenteve në konviktet e “Qytetit Studenti” në Tiranë, është arrestuar gjatë ditës së diel nga Policia e Tiranës. Sipas burimeve, në pranga ka rënë 74 vjeçari Selfo Danaj, i cili u kap në flagrancë duke kryer veprime të turpshme ndaj një studenteje. Mësohet se, i moshuari që kishte kohë që ishte kthyer një një shqetësim për studentet, është denoncuar në polici nga një studente e një prej godinave në Qytetin Studenti, e cila ka shprehur se përballë çdo ditë me veprimet perverse të të moshuarit, i cili kishte filluar t'i shpeshonte veprimet e tij të turpshme prej një “ashiku” plak.

POLICIA
“Ngjarja ka ndodhur në “Qytet Studenti”, ku 74-vjeçari Selfo Danaj ka kryer veprime të turpshme me shtetasin me iniciale S.S.”

NGJARJA

Një prej studenteve e cila ishte akomoduar në zonën e Qytetit Studenti në Tiranë, për të ndjekur universitetin, ishte prej disa kohësh e ngacmuar seksual nga një 74-vjeçar. Sipas policisë, ngjarja ka ndodhur në “Qytet Studenti”, përballë godinës 23, ku 74-vjeçari Selfo Danaj ka kryer veprime të turpshme ndaj shtetasin me iniciale S.S. I moshuari, banues në Tiranë, u denoncua nga studentja 22 vjeçare e cila është shprehur se bezdiset prej kohësh nga Danaj, dhe se përballë çdo ditë me veprimet perverse të 74-vjeçarit para dritares së saj. Gjithashtu, sipas burimeve bëhet me dije, se i moshuari e kishte rutinë të përditshme, që në ambientet e disa prej godinave të Qytetit Studenti, të kryente ngacmime seksuale edhe ndaj vajzave të tjera. Po ashtu, ky nuk është rasti i parë që të rejtat e akomoduar në konviktet e “Qytetit Studenti” bëhen objekt sulmi nga maniakë seksualë.

ARRESTIMI

Pas denoncimit që studentja 22 vjeçare bëri në Policinë e Tiranës, 74 vjeçari u kap në flagrancë nga blutë e kryeqytetit. Mësohet se Danaj është arrestuar duke mos e ditur se vajza kishte lajmëruar policinë. Ndërkohë, sipas policisë, 74-vjeçari do të përballlet me akuzën e veprimeve të turpshme, ndërkohë që po hetohet nëse aktet e tij kanë qenë të përsëritura edhe kohë më parë.



Rrefimet

Studentja

“Bezdisem prej disa kohësh nga Danaj, dhe përballëm çdo ditë me veprimet perverse të 74-vjeçarit para dritares sime. Ky nuk është rasti i parë që të rejtat bëhen objekt sulmi nga maniakë seksualë”

I moshuari

74 vjeçari Selfo Danaj, banues në Tiranë, është arrestuar në flagrancë nga policia e kryeqytetit duke mos e ditur se studentja 22 vjeçare kishte lajmëruar policinë. I moshuari do të përballlet me akuzën e veprimeve të turpshme

Berat

“Makineta”, procedohen në gjendje të lirë 5 persona

— Pesë persona janë nën hetim në gjendje të lirë nga ana e Policisë së Beratit nën akuzën e “organizimit të lotarive të palejuara”. Procedimi penal, pas operacionit të koduar “Makineta”, nisi ndaj shtetasin me iniciale, L.V. 47 vjeç, M.V. 22 vjeç, E.P. 27 vjeç, I.D. 24 vjeç dhe A.B. 43 vjeç. Procedimi ndaj këtyre shtetasve, filloi pasi gjatë kontrollit të ushtruar

nga ana e shërbimeve të policisë, në lokale të tyre, janë konstatuar duke ushtruar aktivitetin e lojrave të fatit si dhe vënien e lokaleve në dispozicion të tyre, pa leje. Policia sekuestrroi në cilësinë e provave materiale 10 makineri dhe një kompjuter lojërash fati. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat për veprime të mëtejshme.



Elbasan, pranga mashtruesit 46 vjeçar

— Policia e Elbasanit ka vënë në pranga gjatë ditës së djeshme një shtetas 46 për mashtrim. Burime nga policia e Elbasanit bëjnë me dije se në kuadër të operacionit “Administratori” është arrestuar Bekim Alla, 46 vjeç, banues në Zgosh të Librazhdit. Sipas hetimeve rezultoi se 46-vjeçari me anë të mashtrimit, duke u paraqitur si administrator i një firme elektrike fiktive punësonte shtetas të ndryshëm në qytetin e Elbasanit dhe nuk i paguante.



Makina përplas për vdekje këmbësorin

— Një automjet ka përplasar për vdekje një këmbësor pranë zonës së Kthesës së Kamzës gjatë orëve të vona të mbrëmjes së të dielës. Aksidenti ndodhi rreth orës 23:00. Si pasojë e këtij aksidenti një person mbeti i vrarë, identiteti i të cilit ende nuk bëhet me dije, ndërsa policia shoqëroi në komisarjat drejtuesin e mjetit tip Benz me targë AA947GL, shtetasin Skerdi A. që përplasi këmbësorin.

» HETIMI

DREJTORIA e Pastrimit të Parave, zbuloi operacionet e dyshimta të firmës "Fled Comunation", që rezultojn në emër të David dhe Florian Kusta. Në dy vjet gjeneroi rreth 15 milion euro.

Aktiviteti
Sipas burimeve të prokurorisë, kompania ushtron aktivitetin tregtar në qytetin e Fierit, shitje blerje, tregtim të trafikut telefonik me shumicë.



Prokuroria e Tiranës

Detajet

Pastrim parash
Momentalisht hetimet kanë nisur për pastrim parash, dhe se të dyshuarit kryesore janë vllëzërit nga qyteti i Fierit David dhe Florian Kusta.

Operacionet
Kjo shifër, është ndarë në disa operacione monetare, si jashtë ashtu dhe brenda vendit, ndërkohe që dyshime të forta janë krijuar mbi burimin real të këtyre parave.

Ngjarja Pukë
Vodhi lekët e pikës së basteve e raportoi si grabitje

— Policia e Pukës ka arrestuar ditën e djeshme një 26-vjeçar për kallëzim të rremë. Burime nga policia bëjnë me dije se i riu Edison Kurtaliali kishte humbur lekët e xhiros në lloton ku punonte dhe pas kësaj telefonoi në polici se ishte grabitur dhe ishte lidhur në pisha nga dy persona. Pas marrjes së njoftimit policia është nisur drejt vendngjarjes ku e ka gjetur të lidhur 26-vjeçarin, pas kësaj ka nisur hetimet për vjedhje. Por policia ka zbardhur të gjithë ngjarjen duke provuar faktin e mashtrimit nga 26-vjeçari, fakt që sipas policisë është pranuar edhe nga ai vetë, pasi ka sekuestrua kompjuterin e punës së 26-vjeçarit ku ka verifikuar edhe lëvizjet e fudit. Rezultonte se ky i fundit kishte vendosur 130.000 lekë bast por e kishte humbur atë. Materialet hetimore ndaj shtetasit Edison Kurtaliali janë referuar prokurorisë së Pukës.

Një vendim i pak ditëve më parë i gjykatës së Tiranës, ka ngrirë një shifër prej 750 mijë euro, të kompanisë tregtare "Fled Comunation" që ushtron aktivitetin e saj tregtar në qytetin e Fierit. Shifra e madhe është pikasur fillimisht nga Drejtoria e Pastrimit të Parave pranë Ministrisë së Financave, e cila më pas i ka referuar informacion njësisë hetimore Task-Forcë, ku pas verifikimeve të kryera është vendosur që shifra e dyshimtë prej 750 mijë euro të sekuestrohet. Ka qënë prokuroria e Tiranës ajo që ka nisur hetimet dhe që më pas i ka kërkuar gjykatës së Tiranës, të verë nën masën e sekuestros shumë të sipërcituar. Për këtë çështje prokuroria ka nisur një procedim penal kundër pronarëve të kompanisë "Fled Comunation", të cilët janë vllëzërit David dhe Florian Kusta. Sipas burimeve të prokurorisë, kompania ushtron aktivitetin tregtar në qytetin e Fierit, shitje blerje, tregtim të trafikut telefonik me shumicë.

Gjykata i ngrin 750 mijë euro kompanisë private

Task-Forcë nis hetimet për vllëzërit nga Fieri Florian dhe David Kusta. Verifikim transaksioneve bankarere

erit David dhe Florian Kusta.

KOMPANITË E TJERA

Dy vllëzërit të dyshuar për pastrim parash, dhe që aktualisht gjykata e Tiranës i ka ngrirë një shumë prej 750 mijë euro, nuk zotërojnë vetëm kompaninë "Fled Comunation", por edhe kompani të tjera.

Sipas prokurorisë në pronësi të vllëzërve Kusta janë kompanitë "Fled Group" dhe "Plastik Alb". Në këtë kompani, prokuroria shton se janë aksionerë dhe dy shtetas italian, ndërkohe që në ditët në vijim do të verifikohen të gjitha bilancet e këtyre kompanive, me qëllim nxjerrjen e bilanceve dhe xhenerimin e shumave të mëdha.



Gjykata e Tiranës



15 MILION EURO

Në materialin referuar prokurorisë së Tiranës, zyrtarët e Drejtorisë së Pastrimit të Parave kanë evindetur se kompania e mësipërme brenda dy viteve ka lëvizur një shumë prej 15 milion euro. Kjo shifër, është ndarë në disa operacione monetare, si jashtë ashtu dhe brenda vendit, ndërkohe që dyshime të forta janë krijuar mbi burimin real të këtyre parave. Prokuroria shton se në ditët në vijim do verifikojnë me imtësi të gjitha bilancet e kësaj kompanie, për të mësuar të ardhurat që xheneron kjo kompani nga aktiviteti i saj tregtar. Momentalisht hetimet kanë nisur për pastrim parash, dhe se të dyshuarit kryesore janë vllëzërit nga qyteti i Fi-

Doshi pas tre javësh rikthehet në Gjykatë e Lartë, kërkon lirinë

Deputeti do ndryshimin e masës së "arrestit në shtëpi"



Tom Doshi

deklaroi se gjithëcka ishte një sajese midis Doshit, Mark Frrokut e të riut nga Fushë-Kruja, Durim Bami. Tom Doshi ndodhej në "arrest shtëpie" prej 28 marsit,

kur Gjykata e Lartë vendosi këtë masë arresti pas akuzave të bëra nga Prokuroria ndaj tij dhe deputetit tjetër Mark Frroku masën "arrest në shtëpi". Pesëshja e gjyqtarëve që vendosën arrest në shtëpi për Doshin dhe Frrokun ishin Guxim Zenelaj, Aleksandër Muska, Admir Khanxa, Majlinda Andrea dhe Artan Zeneli. Sipas avokatëve të Doshit, ai akuzohet se ka bërë "kallëzim të rreme" në një kohë kur vetë deputeti nuk ka bërë asnjë kallëzim në prokurori dhe në polici. Akuzohet dhe për dy vepa penale të tjera, për të cilat

sipas avokatit Meçi ai nuk i ka kryer dhe nuk ekziston në dosje asnjë provë bindëse. E njëjta trupë gjyqtarësh vendosi më 30 mars masën arrest me burg për të riun nga Fushë-Kruja, Durim Bami. Pa kaluar shumë ditë nga masa e arrestit në shtëpi për deputetin Mark Frroku, në datën 2 prill të këtij viti Frroku u riarrestua sërisht këtë herë për akuzën e vrasjes me paramendim të shtetasit Aleksandër Kurti në Belgjikë. Momentalisht Frroku vijon të qëndrojë në burg në ambientet e paraburgimit 302 në kryeqytet.


ASETET e kompanisë do të mbeten të bllokuara deri në një vendim të dytë nga ana e përmbaruesit



Rrjeti

Në Shqipëri, "Carrefour" operon me 2 hipermarkete nën brandin "Carrefour", duke ofruar çdo gjë nën një çati dhe 17 supermarkete nën brandin "Carrefour market"

AKEP



2014, 5,400 lekë shpenzime për celularin

Sipas raportit vjetor të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe postare, të ardhurat e sipërmarrëve më të mëdhenj të telefonisë celulare janë reduktuar ndjeshëm në 2014, gjë që ka çuar edhe në reduktim të të ardhurave të sektorit. Të ardhurat e operatorëve celularë në 2014 u reduktuan me 13%, nga 37 miliard lek në 2013 në 32 miliard lek në 2014. Po ashtu, nga raporti rezultoi se çdo përdorues i telefonisë celulare shpenzoi gjatë vitit 2014 mesatarisht 5400 lekë për komunikimin me celular. Nga të dhënat vihet re se të numri i përdoruesve të shërbimeve bazë GSM ka rënë me 8-9%, ndërkohë që treguesit e volumit të shërbimeve të thirrjeve telefonike dhe mesazheve SMS janë me rritje 8-47%. Thirrjet hyrëse ndërkombëtare kanë reduktim me 29%, ndërkohë që terminimi i thirrjeve nga rrjetet kombëtare ka rritje me 78%, e cila vjen rritja e trafikut off-net. Treguesit e volumit të shërbimeve 3G janë të gjithë me rritje. Në fund të vitit 2014, numri i përdoruesve të telefonisë së lëvizshme sipas kartave SIM aktive, arriti në 4.9 milion krahasuar me 5.3 milion në fund të vitit 2013. Ka vazhduar tendenca e paketave tarifore të ulëta për thirrjet brenda rrjeteve,


Borxhet, nën sekuestro asetet e "Carrefour"

Kompania s' shlyen furnitorët, bllokohet nga përmbarimi

LORENC RABETA
TIRANE

Detyrimet e pashlyera ndaj furnitorëve kanë sjellë sekuestrimin e asetëve të kompanisë "Carrefour" nga ana e një shoqërie përmbaruese. Shoqëria përmbarimore ka vepruar për


llogari të dy kompanive të tjera tregtare që furnizojnë rrjetin e supermarketeve, ndërsa vetë dega e "Carrefour" në Shqipëri rezultoi se u detyrohet kompanive përkatësisht 5,5 dhe 3,52 milionë lekë. Më saktësisht, kundrejt kompanisë "Luku", Carrefour ka një detyrim prej rreth 5,5 milionë lekësh, ndërsa kundrejt kompanisë "Euronuovo" 3,52 milionë lekë. U bë me dije se asetet e kompanisë do të vendin të bllokuara deri në një vendim të dytë nga ana e përmbaruesit.



Furnitorët
Saktësisht, kundrejt kompanisë "Luku", Carrefour ka një detyrim prej rreth 5,5 milionë lekësh, ndërsa kundrejt kompanisë "Euronuovo" 3,52 milionë lekë



Borxhet
Rrjeti më i madh i supermarketeve në vendin tonë duket se ka një histori të gjatë me detyrimet që ka ndaj furnitorëve. Borxhet ndaj tyre kanë nisur nga 2012



Bilanci
Detyrimet ndaj furnitorëve janë më të larta edhe se kreditë që ky grup supermarketesha ka marrë nga bankat tregtare, si në temat afat-shkurtër, ashtu edhe në tema afat-gjata

sekuestro. Rrjeti më i madh i supermarketeve në vendin tonë duket se ka një histori të gjatë me detyrimet që ka ndaj furnitorëve. Vetëm për vitin 2012 këto detyrime arrinin në vlerën e 867 milionë lekë (afërsisht 8,6 milionë dollarë), ndërsa në vitin 2013 arrinin një vlerë prej 892 milionë lekë (afërsisht 9 milionë dollarë).

BILANCI
Detyrimet ndaj furnitorëve janë më të larta edhe se kreditë që ky grup supermarketesha ka marrë nga bankat tregtare, si në periudhë afat-shkurtër, ashtu edhe në periudhë afat-gjatë. Ndërsa kompania që ka blerë aksionet e grupit "Carrefour" ka në pronësi edhe linjën e supermarketeve "Euromax". Në Shqipëri, "carrefour" operon me 2 hipermarkete nën brandin "Carrefour", duke ofruar çdo gjë nën një çati dhe 17 supermarkete nën brandin "Carrefour market", me vendodhje në Tiranë, Durrës, Vlorë dhe Fier.

DETYRIMET

Shoqëria "Carrefour" është e pranishme në vendin tonë që nga viti 2001, ndërkohë që në muajin Janar të këtij viti grupi ka ndërruar pronësi,

duke kaluar 100% të aksioneve në duart e kompanisë "CM Balkans BV". Ajo që duhet theksuar është se kjo nuk është hera e parë që asetet e kompanisë në fjalë vihen nën

duke kaluar 100% të aksioneve në duart e kompanisë "CM Balkans BV". Ajo që duhet theksuar është se kjo nuk është hera e parë që asetet e kompanisë në fjalë vihen nën

Projektligji, gati liberalizimi i shërbimit postar në vend

Shërbimi universal mund të ofrohet nga disa subjekte

Ndryshimet
TIRANE

Komisioni Parlamentar i Ekonomisë ka miratuar dje në parim projektligjin për Shërbimin Postar. Kreu i Postës shqiptare Majlind Lazimi është shprehur se ky ligj është pjesë e planit kombëtar të integritimit. Ndërsa emetimi i Pullës Shqiptare i lhet postës shqiptare. "Duke siguruar një minimum shërbimesh me një cilësi të specifikuar të cilat do duhen të ofrohen në gjithë ter-

ritorin e Shqipërisë me çmime të njëjta për përfitimet e gjithë përdoruesve pavarësisht vendndodhjes së tyre geografike pavarësisht nëse këto qytetarë ose këto përdorues janë në zona urbane nëpër qytete apo në zona rurale apo në fshatra të ndryshme. Edhe në ligjin e ri janë parashikuar dispozita të veçanta në lidhje me emetimin e pullave postare shqiptare e drejta e emetimit të pullës postare, pra pullës postare shqiptare i lhet edhe me këtë projektligj Postës Shqiptare", u shpreh Lazimi. Deputeti demokrat Ridvan Bode u shpreh se ky projektligj lëshohet për pjesëmarrje në treg të personave jo kompetitiv. Projektligji për



Majlind Lazimi

shërbimin postar u miratua nën parim në Komisionin Parlamentar të Ligjeve. Referuar projektligjit të propozuar nga ministria e Shtetit për

Inovacionin, AKEP-i mund të caktojë një ose më shumë ofrues të shërbimit universal, për të garantuar shërbimin në të gjithë territorin e vendit.

Strategjia

Gazpromi, mjet presioni në duart e Moskës

Gazpromi po ia kthen shpinën BE-së, dhe Rusia ka nisur në ndërtimin e një gazsjellësi me Greqinë. Kjo nuk është një kundërtënie, por pjesë e strategjisë gjeopolitike. Gazpromi do ta reduktojë aktivitetin në Europë. Në këtë mënyrë koncerni heq dorë nga përpjekjet për kontrollin e tregut. Gazpromi po i shtet aksionet nga sipërmarrjet për furnizim. Ndërkohë që planet për ndërtimin e centraleve janë futur në sirtarë. Bashkimi Evropian, monopolin e këtij koncerni gjithmonë e ka pasur halë në sy. Komisioni i BE ka nisur proceset kundër Gazpromit, për shkak të monopolit. Koncerni nga ana tjetër, nuk ka qenë kurrë i gatshëm t'u përmbahet rregullave antimonopoliste të BE. Ndaj pritej tërheqja e pjesësme e Gazpromit nga tregu i BE-së: gazi do të duhet të vazhdojë të furnizohet edhe më tej. Sikur të mos kishte kontradikta ekonomike dhe mosmarrëveshje politike.

» RREZIKU

PASAGJERËT Defekti i shfaqur gjatë fluturimit ka detyruar avionin e "Blue Panorama" të ulet dy herë në Rinas pak çaste pasi ishte nisur nga aeroporti ndërkombëtar "Nënë Tereza"

Avaria, "Blue Panorama" ulje të detyruara në Rinas

Një pjesë e udhëtarëve refuzuan të rinisin udhëtimin

LORENC RABETA
TIRANE

Reth 50 pasagjerë kanë përjetuar panik në fluturimin e tyre me kompaninë "Blue Panorama" nga Rinas drejt Firences, ku piloti ka vendosur të bëjë ulje emergjence pasi një prej motorëve të avionit është fikur në fluturim. Një defekt teknik gjatë fluturimit ka detyruar avionin e "Blue Panorama" të ulet në Rinas pak çaste pasi ishte nisur nga aeroporti ndërkombëtar "Nënë Tereza". Në fluturimin e parë të orës 07:00 të këtij mëngjesi, "Blue Panorama" ka pësuar avari në motor duke bërë uljen e parë të detyruar në aeroport. Burime për A1Report thanë se pas uljes së detyruar të gjithë pasagjerët zbritën nga avioni

Rruga



TIRANE

Unëshkrua dje mes Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe kompanive "Joint Venture Sintram Albania" dhe "Combined Group" kontrata e fillimit të punimeve për segmentin Qukës - Qafë Plloçë. "Sot konkludojmë kontratën për punimet në rrugën Qukës-Qafëplloçë, një vepër e rëndësishme e infrastrukturës rrugore shqiptare, një segment shumë i rëndësishëm i Korridorit 8-të, që përmirëson ndjeshëm lidhjet e Shqipërisë me fqinjët jugorë dhe jug-lindor, e veçanërisht i shërben ekonomisë dhe turizmit të zonës, por i shërben shumë edhe punësit të gjithë banorëve të zonës së Quksit, Mokrës dhe Pogradecit, pasi është një vepër e cila kërkon angazhime të mëdha si në fuqi inxhinierike ashtu edhe në kapital njerëzor për realizimin e saj" - tha Ministri Haxhinasto.

Ministri vuri theksin në rëndësinë që ka aplikimi i standardeve dhe cilësisë në

deri në rregullimin e defektit, por një pjesë e tyre refuzuan të rinisin udhëtimin me kompaninë ajrore italiane "Blue Panorama". Po sipas këtyre burimeve, pasagjerëve nuk i janë dhënë bagazhet dhe as lektë e biletës duke i detyruar të hipin sërish në avion me destinacion Firencen në Itali.

TENTATIVAT

Qëndrimi në pistë ka zgjatur për afro dy orë dhe pas një servisi të kryer është tentuar sërish ngritja. Por edhe nisja e dytë e fluturimit rreth orës 09:30 ka shkaktuar panik tek udhëtarët, pasi defekti në motor është shfaqur sërish pak pas ngritjes nga Rinas duke



bërë për së dyti ulje të detyruar në aeroport. Vendimin për tu ngritur sërish në fluturim e ka marrë komandanti i avionit, piloti i parë i cili ka parë të arsyeshme se avioni është në kushte për të qar në fund udhëtimin, edhe pse parashikimi i tij nuk doli ashtu siç pritej! Sipas kompanisë avioni është ngritur nga Tirana për destinacionin e Firences, por u kthye në aeroport për kontroll të teknike, "pa deklaruar asnjë emergjencë". Po sipas kompanisë avioni nuk ka bërë asnjë ngritje ose ulje e dytë: vetëm është rrotulluar në pistë, për të vlerësuar mundësinë për të proceduar me zëvendësimin

e një komponenti në origjinën e anomalisë. Pas kësaj ecje në pistë kompania ka urdhëruar anulimin e fluturimeve drejt destinacioneve të Firence e Ancona. Pasagjerët të cilët preferuan të qëndrojnë anonim sgaruan për A1Report thanë se kompania "Blue Panorama" i ka deklaruar se gjithçka është në rregull. Shumica e pasagjerëve kanë kërkuar rimbursim biletash por përgjigja nga Blue Panorama ka qenë se rimbursimi do të kryhet pas një muaji, e në këto kushte pasagjerët të ndryshëm kanë ndryshuar destinacionin dhe disa prej tyre kanë riprërë një biletë me shpenzimet e tyre.

Kompania
Pasagjerëve nuk i janë dhënë bagazhet dhe as lektë e biletës duke i detyruar të hipin sërish në avion me destinacion Firencen në Itali



Nëshkruhet kontrata për segmentin Qukës-Qafë Plloçë

Haxhinasto: Rruga shumë e rëndësishme për ekonominë e zonës




Për herë të parë në këtë vepër do të aplikojmë standard të ri, me gjerësi të rrugës 12 metra" - tha ai. Projekti i ndërtimit të rrugës Qukës - Qafë e Plloçës, pjesë e korridorit rrugor Tiranë - Korçë (Korridor VIII), së bashku me ndërtimin e rrugës Tiranë - Elbasan do të sigurojë një lidhje më të shpejtë midis portit të Durrësit e vendeve të tjera të Ballkanit, duke e bërë Shqipërinë vend më të përshtatshëm për të

kryer tranzitin e transportit nga vendet e Ballkanit drejt Evropës dhe anasjelltas. Kjo rrugë shërben, gjithashtu, si një bypass për qytetin e Pogradecit, një nga kryeqendrat turistike të Shqipërisë. Juglindore, duke shmangur kështu ndotjen e qytetit dhe liqenit, si pasojë e tranzitit të mjeteve të rënda, duke çuar në rritjen e komoditetit turistik në këtë rajon duke sjellë rritjen e numrit të turistëve.

Bujqësia

Panariti:
Monitorim
online i sistemit
të ujëtjes



Administrimi i sistemit të ujëtjes dhe kullimit në vend do të bëhet për herë të parë përmes monitorimit online. Prezantimi i këtij instrumenti të ri që do të modernizojë administrimin e sistemit u bë dje në prani të Kryeministrit Edi Rama dhe Ministrit të Bujqësisë Edmond Panariti. Ky instrument do të transformojë dhe modernizojë të gjithë sistemit të administrimit të ujëtjes dhe kullimit në vend. Përmes sistemit të monitorimit bëhet gjurmimi dhe kontrolli në kohë reale, falë teknologjisë, i kapaciteteve teknike të sistemit ujëtës dhe kullues në të gjithë territorin. Ai ka të bëjë me gjurmimin në kohë reale të të gjitha kapaciteteve motorike pranë bordeve të kullimit, duke filluar nga pozicioni i tyre, vëllimi i punës dhe historikun e gjithë punëve të bëra. Ministri Panariti theksoi se sistemi i gjurmimit do të shmangë abuzivizmin që për vite me radhë ka shoqëruar këtë sektor dhe do të maksimizojë efektivitetin e fondeve publike për pastrimin e kanaleve për veprat ujëtase dhe në tërësi, për mirëmbajtjen e gjithë sistemit të kanaleve ujëtase dhe kulluese. "Qeveria shqiptare e ka të qartë rrugën dhe objektivat e saj për ndryshimin rrënjësor të sistemit të vaditjes dhe të kullimit, por këto objektivat tona janë që të kemi një shtim të sipërfaqes së vaditur me 90 mijë hektarë, aq sa ka qenë sipërfaqja në këto 25 vite, pra e kemi filluar në vitin 1990 me 90 mijë hektarë, pra nuk kemi ndryshuar, dhe për 25 vite nuk kemi ndryshuar nga kjo sipërfaqe, pra objektivi ynë është ambicioz por me këmbë në tokë, pra në jemi të vendosur të rrisim me 90 mijë hektarë këto edhe për garantimin, e funksionit të skemave ujëtase, edhe për 120 mijë hektarë të tjerë, deri në vitin 2017", tha Panariti.

Ka diçka që nuk shkon në jetën tonë



NGA ILIR DHIMA

vijon nga faqja 1

Dhe për t'u mbyllur gojën, nga kompania private, madje edhe prej institucionit shtetëror i Sizmiologjisë dëgjohej gjithnjë e më dendur justifikimi, se kishin të bënin jo me vepra kriminale, por me tërmete natyrore. Deri sa erdhi një ditë që pusët të villnin mbi tokë fontana naftë, gazi dhe uji të injektuar brenda tyre, aq sa jeta në atë zonë është bërë pothuajse e pamundur në një territor të infektuar. Dhe përsëri, për të "qetësuar" revoltën e natyrshme të atij komuniteti njerëzish të thjeshtë, kompania private lëshoi garancitë, sipas të cilave, çlirimi i gazrave nuk ishte i rrezikshëm dhe uji - ëmbëlsisht i pijshëm. Pra, dëmit të madh nga ngjaja në kult e interesit privat të ca të huajve, që i është shkaktuar jetës së një komuniteti të tërë, si edhe shtetit tonë për t'u përballur tani me llojin nga sytë këmbët të këtij komuniteti, u ngjishen edhe talljet. Talljet, që shtohen gjithashtu kur shtetit nuk i paguhen vijmësisht taksat apo tatimet dhe banorëve asnjë qindarkë dëmshpërblim.

Po të ishte kjo tablo e zymtë e vetmja që është ekspozuar në vendin tonë gjatë periudhës paskomuniste, fare mirë do të flitej për një aksident të një rasti të veçantë, pas të cilit mund të nxirreshin mësimet dhe të korigjoheshin shumë gjëra për të ardhmen. Por pa u munduar t'i thirrte kujtesës, le të shohim ndërkohë "retë e kuqe" me të cilat gdhëhet qyteti i Elbasanit. Megjithatë nga Ministria e Mjedisit udhërohet që të pezullohet puna e Kompanisë metalurgjike turke, deri sa të plotësohen parametrat përkatës, "Kurum" përsëri i vë gjatë natës në punë furnat e shkrirjes, pa aktivizuar filtrat e nevojshëm. Ose, ja edhe Bulgizia apo minierat e tjera të kromit në Martanesh dhe në Mat. Ndër vite e në vazhdim, çuditërisht pasuria e përbashkët e këtij populli u marrë jetën njerëzve të thjeshtë të tij, duke lënë në varfëri të skajshme dhe në memorie të ndryshkur edhe fatin e familjeve të tyre.

Gjithçka nga sa u përmendën pak më lart, por edhe plot raste të tjera të aty - këtu shme vazhdon të ndodhë, kur nën kujdesin e organizave ndërkombëtare është botuar edhe në Shqipëri prej vitit 2004 "Libri i Bardhë për Përgatitjen e Vendeve të Asociuara të Evropës Qendrore dhe Lindore për Integrimin në Tregun e Brendshëm Evropian", me qindra faqe. Për plotësimin e rekomandimeve të këtij Libri, në vitin 2007 u hartua nga Qeveria shqiptare dhe u publikua prej saj "Plani Kombëtar për Zbatimin e marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit 2007-2012", sikurse u hartua edhe një Plan Veprimi me mbi një mijë akte juridike, nga zbatimi i të cilave, zhvillimi këtu mund të kishte njohur kuota mjaft premtuese. Kuota të tilla, po të merret parasysh përmbajtja e këtyre dokumenteve: Politika Komunitare e Mjedisit me nivel të lartë mbrojtjeje; Legjislacioni i BE, midis të tjerash, edhe për luftën ndaj ndotjes së ajrit; Diraktivat për mbrojtjen e mjedisit, veçanërisht të tokës; kuadri tekniko-ligjor për hidrokarburet; ai mbi kushtet dhe dhënien e autorizimeve për zbulimin, eksplorimin, prodhimin dhe eksportimin e mineraleve etj etj.

Të përqendrohesh në këto pak rradhë të përgjegjësitë e ish qeverisjeve dhe e personave të veçantë, për prapambetjen e rrezikshme që i shkaktuan dhe i lejuan ata këtij vendi, ndoshta do të ishte veçse sipërfaqësore. Përpos kësaj, mbase nuk ia vlen që në një artikull të shkurtër të mjaftohesh vetëm duke drejtuar gishtin të fajtorët, të cilët përpiqen të lajnë duart si Pont Pilati dhe, nëse lejoheshin, të vazhdonin me të njëjtin avaz. Por, nuk do të ishte i tepër këtu theksimi i atyre priprjeve që shoqëruan pa ndërprerje këtë prapambetje: admirimi i verbër ndaj tregut të lirë dhe i të gjitha paqartësive të tij; lehtësia për t'u shtrirë dorën pa pushim institucioneve bankare për kredi deri edhe me terma tregtarë, që nuk është e lehtë të shlyen; përcmimi i rëndësishëm sektori publik; vegimi i një zhvillimi pa kufij. Këtyre në këtë çerekshkullin i është njohur çmimi, por u janë anashkalluar vlerat, duke vënë në piedestal interesin material dhe atë vetjak, aq sa disave u bëhëj zemra mal, kur shihnin dëshitim të shtetit në të gjitha rrafshet.

Ndonëse në vitet e para të këtij shekullit të ri, shteti i mirëqenies sociale nuk ka gëzuar kurrë më shumë se sa në të kaluarën një përfaqje të veçantë nga përfituesit e tij, pra, kur në asnjë vend të botës zgjedhësit nuk kanë qenë "pro" masave shtetërore ndaj sektorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, të transportit publik apo të subvencionuar, të furnizimit me energji elektrike, si



edhe të shërbimeve të tjera bazë, në Shqipëri ka ndodhur e kundërta, domethënë, një priprje që shkelte me këmbë çdo rregull, madje edhe atë të jetës. Qeveritë e mëparshme më së shumti kanë rrahur gjoksin për zhbërrje të fuqisë shtetërore dhe për politikë fiskale të zbehta, për kalimin e shumçkaje që ishte arritur nga sektorët publikë në veprimtarinë e personave privatë. Linjat hekurudhore që s'e patën këtë fat, në vend të modernizoheshin u shkatërruan edhe më tepër. Në drejtime të tjera, kur shteti ka shitur lirë vepra, vendburime, troje dhe shërbime pa për një krodhe bukë vetëm e vetëm për të mbajtur në pushtet klika të korruptuara, vetë shteti është ai që e ka pësuar shtrenjt: qeveritë që nuk duan të mbajnë mbi shpinë përgjegjësitë e misionit të shërbimeve publike, faktikisht braktisin tiparet themelore të shtetit modern. Në vijim, shumë më pak vlera përtohen nga mënyra e mbrapshtë e administrimit të një sistemi të rregullt të financave publike, çka nxit natyrshëm zemërimin e taksapaguesve.

A mund të vazhdohet kështu më gjatë? Edhe vendeve me ekonomi të zhvilluara dhe me institucione demokratike të konsoliduara, kriza e vitit 2008 ua bëri të ditur që armiku më i keq i kapitalizmit të pacak është vetë ai: herët a vonë do të bjerë viktimë e vetes dhe do të kërkojë shpëtim nga shteti. Por, nga një shtet si ky yni, me financa të zbrazura apo deficitarë, vështirë të priten zgjidhje shpëtimtare. Sepse, në një vend si ky yni, edhe pasuria e përbashkët e lënë të shfrytëzohet - për më tepër pa kriter dhe as fare perspektivë - vetëm nga një grupit i vogël sipërmarrësish grykës, doemos që kthehet në një bumerang për njerëzit në masë, ashtu si edhe për shtetin. Në këtë kuptim, edhe ulja e nivelit të pabarazisë është përparsi e përparsive. Nëse ajo zë gjithnjë e më fort rrënjë, atëherë çdo gjë e mirë

që do të synohej më vonë të arrihej, me gjasë do të bëhej pothuajse e pamundur.

Prandaj, një qëndrim kritik progresist ndaj zhvillimeve këtu është e domosdoshme që të përqendrohet te prania apo shfaqja e tërëllojshme e pabarazisë, që nga të drejtat më jetike të individit. Ndërkohë, pabarazia nuk është vetëm një problem që kërkon zgjidhje teknike. Ajo nxjerr në pah dhe më tej thellon dobësitë e marrëdhënieve të mirëfillta shoqërore. Pra, ndjesinë e të jetuarit, në një bashkësi anëtarësh mëndjecekët dhe viziongushtë, që ruajnë të drejta të posaçme vetëm për veten dhe të afërmit e tyre, ndërsa të tjerët nuk i kanë në refene dhe i konsiderojnë thjesht të pafat në jetë. Kjo patologji është cilësuar nga plot ditëtarë të kësaj epoke në gjithë botën si kërcënim serioz që, veç të tjerash, lëndon organet jetike të cilësdo lloj demokracie.

Aktualisht, mbase do të ishte e dobishme që të vritej më shumë mendja, se çfarë do të bëhet me rikonceptimin apo forcimin e rolit të shtetit në jetën e popullit. Qeverisja e Aleancës Progresiste në Shqipëri, në të vërtetë po ndërmerr disa masa në këtë drejtim, kryesisht një reformë pensionesh, një farë zbeheje të kontrasteve në sistemin e pagave etj. Por këto dhe të tjera reforma nuk mund të kenë jetë të gjatë pa e bërë shtetin një subjekt katalizor gjithnjë më efikas në shfrytëzimin dhe administrimin e pasurive të përbashkëta të popullit dhe në shërbime publike për të. Domethënë, për shembull, që ta bëjë atë akcioner autoritar në privatizimet e reja dhe Palë dinitohe të kontratat konçesionare, pavarësisht kërkesave të ngutshme dhe ofertave të mundshme për investimet e huaja direkte apo indirekte këtu. Më së paku, të jetë ai në gjendje për të kontrolluar nga afër shfrytëzimin dhe administrimin e kësaj pasurie, duke përfutur për interesin

e përgjithshëm të ardhura edhe si dividende, por edhe si vjelje taksash e tatimesh. Nëse Pala tjetër ka, siç thamë më lart, afro një çerekshkull duke përkeqësuar e rrituar në mënyrë sistematike, shpresat për t'u bërë më mirë nuk mund të realizohen nga përmirësimet të pjeshme dhe të përkohshme të situatave të rrjedhura prej së kaluarës së afërt.


Prandaj, nuk duket fort e arsyeshme, as e dobishme, fjala vjen, ajo që deklaroi para disa ditësh Ministri i Energjitikës, sipas të cilit, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nuk do të privatizohet këtë Legjistraturë. Por çfarë do të ndodhë pas dy vjetësh, do të ketë përsëri privatizim të këtij sektori jetik për tërë popullsinë?! Përse në një akt ligjor të fundit të hartuar nga kjo Ministri bëhej fjalë për shpronësimet të përkohshme, kur dihet që koncepti juridik i termit 'shpronësim' (sigurisht, për interes publik) kudo ka lidhje me vazhdimësinë, me të përhershmen?! E pra, nëse shmanget zelli për të ndjekur nga pas priprjet teorizuese, mundësia është më e madhe për të dëshuar më pak në përsëritjen e gabimeve të së kaluarës. Dhe, sikurse kanë treguar përvoja të vendeve të tjera, shoqëritë ku lejohet të sundojë pabarazia e theksuar, sidomos ndërmjet individëve të huaj apo vendas dhe shtetit nën juridiksionin e të cilit këta zhvillojnë veprimtari ekonomike, pa dyshim që janë të paqëndrueshme. Ato vuajnë pasojat e ndarjes së thekseshme dhe herët apo vonë bien në pellljet e konflikteve me pasojë që zor se mund të kenë lidhje me demokracinë të zhvillim. Tek e fundit, nëse qëndron ajo që thoshte filozofi britanik Bernard Williams (1929 - 2003), se toleranca është e mbrojtur sot më shumë se kurrë nga "shpërfaqja e mbrapshtë e pabarazisë së saj", e njëjta gjë mund të thuhet edhe për çdo shtet që synon dhe propagandon rritjen e mirëqenies sociale.

Big Brother Veseli luan me zjarrin

Puth Xhensilën, synon të
bëjë për vete edhe Tean

Banori më i ri i "Big Brother 8" ka hyrë në lojë me synime të qarta. Loja e parë e tij në shtëpi ishte me vajzat. Mungesa e cigareve në shtëpi ia bëri atij më të lehtë rolin. Tea ishte synimi i tij i parë, por mesa duket Xhensila e fton herë pas herë. I pyetur nëse ka cigare ai thotë se ka vetëm një. Zaida i kërkon që ta pinë bashkë por ai i thotë se cigaren e fundit e ka rezervuar për Tean. Ai shkon në dhomën e gjumit. Merr dy cigaret e fundit. Njërin vendos që ta fsheh dhe tjetrën e merr duke u thënë që është e fundit. Të kuptosh se kush është plani i tij është e vështirë. Para se të dal ai kujdeset që të lyhet me parfum. Bën disa hapa dhe kthehet sërish pas. Merr parfumin e tij dhe lyen krevatin e Teas. Veseli e ka të qartë situatën tashmë. Banori më i ri në shtëpi shkon në kuzhinë. Ai përqafon Xhensilën, i bënë masazh dhe i jep puthje në qafë. Pas kësaj Fatjoni i afrohet dhe kërkon të njihet me të. Ai e pyet për familjen, jetën që bën


dhe Prizrenin. Veseli i përgjigje pa përtaci. Pasi ai puthë dhe njëherë Xhensilën që vendos të shkojë flejë më të dashurin e saj, del në oborr bashkë me cigaren ku po e pret Tea. Loja me Teas dhe Veselit vazhdoi dhe gjatë të hënës. Veseli i vendosur në gjerat që do, pasi i bën masazh Teas, e përkëdhel dhe e puth në qafë dhe në shpinë. Tea nga ana tjetër, i thotë Veselit të largohet, duke e pyetur se çfarë do? Veseli i shprehet se ato gjera që do, po i merr vet nuk ka nevojë të pyes Tean. Tea herë pas here i kërkon Veselit të largohet se i pengon diellin, duke qëndruar sipër saj. Veseli i vendosur i tregon Teas që nuk ka nevojë të largohet ai që të marrë diellin, sepse diellin e ka aty pranë vetes. Veseli e pyet Tean për masazhin që ai i bëri asaj dhe i premtonte Teas, që do këtë tre herë masazh në ditë prej tij. Veseli nuk ndalet me ledhatimet për Tean, as thirrjet e Teas që të largohet, nuk e ndalin atë. Fatjoni që është aty pranë bën batuta me ta dhe i thotë Teas mos ia ka lë gjë porosi Kika?!



Festivali

Elhaida vazhdon të kryesojë, befason në Amsterdam

— Elhaida Dani ka befatur publikun e Amsterdami edhe në koncertin "Eurovision in Concert". Kënga e Danit është mirëpritur mirë ndërsa menjëherë kanë pasur edhe intervistat me të. Aktualisht kënga e saj "Im alive" është e dyta me klikime nga gjithsej 39 këngët që sivej marrin pjesë në garën e Eurovizionit. Pas Rusisë që numëron mbi 3 milionë klikime, kënga shqiptare sapo ka grumbulluar 2 milionë klikime. Ëvibloggs që merret me lajmet e Eurosong, më 29 mars kishte bërë thirrje për votim se kush mund të jetë fituese në edicionin e këtij viti të Eurosong. "Prej 29 marsit e deri më sot, ne kemi numëruar 55.739 vota. Po kryeson Elhaida Dani, këngëtarja nga Shqipëria. Ajo ka grumbulluar 10.564 vota", ishte shkruar në faqen e Ëvibloggs. Le të shpresojmë që ky votim të shkojë edhe në finalen e Eurovizionit.



Këngëtarja

Rita Ora pjesë e "Fifty Shades of Grey"



— Këngëtarja e famshme me origjinë shqiptaro-kosovare Rita Ora do të luajë në dy seritë e ardhshme të trilogjisë "Fifty Shades of Grey". Edhe pse bëri vetëm një sfaqje të vogël në filmin tepër të përfolur që doli në shkurt, këngëtarja duket se ka arritur një marrëveshje për të luajtur në të tre seritë, në të cilat ajo do të interpretojë motrën e Christian Grey. Lajmi është bërë i ditur nga e-malet e Sony Pictures që dolën nga Ëkileaks.

Kalendari Kulturor

KONCERT/ PALLATI I KONGRESEVE

- Violinisti shqiptar, Olen Cesari do të mbajë një koncert të madh në Pallatin e Kongreseve në Tiranë, ku do të luajë në violinë me grupin e tij "Olen Cesari International". Të ftuar specialë në këtë event do të jenë Ermal Mamaqi, Alban Skënderaj, Elvana Gjata dhe Flori Mumajesi. Violinisti i lindur në Durrës, ka bashkëpunuar me emra të njohur si Bob Dylan, Michel Petruciani, Lenny Kravitz, Claudio Baglioni, Zucchero etj. Artisti ka lançuar albumin e tij të parë "Unexpected" (E papritur) një udhëtim me koncerte në disa vende të botës, përfshirë Shqipërinë. "Në koncertin tim të fundit në Paris, erdhën 30 miq nga Roma. Më 23 prill në Tiranë, vërtet dua të shoh sesa miq do të vijnë nga Italia... 1 orë fluturim... Shpërndajuni lajmin të gjithëve", shkruan Cesari në "Facebook", ndërsa shitja e biletave ka përfunduar.



PROGRAMI I FILMAVE NE RRJETIN IMPERIAL PER DT 16.04.2015 - 22.04.2015

SALLA 1

- "Get Hard" 2D / 20:30 / Çmimi 500 Leke
- "Run All Night" 2D / 22:15 / Çmimi 500 Leke
- "The Longest Ride" 2D / 15:30 / Çmimi 500 Leke
- "Fast & Furious 7" 2D / 13:00 / 18:00 / Çmimi 500 Leke
- Tinkerbell: Legend of the Neverbeast" 2D / 10:30 / Çmimi 400

SALLA 2

- "Get Hard" 2D / 18:30 / Çmimi 500 Leke
- "Run All Night" 2D / 13:30 / 21:00 / Çmimi 500 Leke
- "Fast & Furious 7" 2D / 11:00 / 16:00 / Çmimi 500 Leke



- "Get Hard" 2D / 22:15 / Çmimi 500 Leke
- "Run All Night" 2D / 17:30 / Çmimi 500 Leke
- "Tinkerbell: Legend of the Neverbeast" 2D / 10:00 / Çmimi 400 Leke
- "Fast & Furious 7" 2D / 12:30 / 15:00 / 20:00 / Çmimi 500 Leke

Premiere Dt 23.04.2015

- 1- The Second Best Exotic Marigold Hot 2D
- 2- The Age Of Adaline 2D

» EDICIONI 3

ARTISTI shqiptar është pjesëmarrës në edicionin e 3-të të Bienales së Artit Bashkëkohor D-o ARK Underground në Konjic. Kuratorë janë Margarethe Makovec & Anton Lederer dhe artistja shqiptare Adela Demetja

Helidon Gjergji ekspozon në bunkerin atomik të Bosnjes

Artisti njofton se ka paraqitur një performancë të veçantë, një vepër në videoinstalacion që titullohet "Tango down"

DHURATA HAMZAI
TIRANE

Artisti shqiptar, Helidon Gjergji, do të jetë pjesëmarrës në edicionin e tretë të Bienales së Artit Bashkëkohor D-o ARK Underground në Konjic, Bosnje-hercegovinë. Gjergji njofton për gazetën se ka paraqitur një performancë të veçantë në videoinstalacion që titullohet "Tango down". Kuratorë të bienales janë Margarethe Makovec & Anton Lederer dhe artistja shqiptare Adela Demetja. Çelja e bienales do të bëhet të premten më 24 prill 2015, në orën 11:00. Helidon Gjergji me banin në Nju Jork është një emër i njohur në botën e artit ndërkombëtar. Veprat e karrierës së tij përfshijnë piktura, grafika, video arti, si dhe instalacione të shumta artistike nëpër galeri arti apo në mjedise publike. Krijimet e artistit janë ekspozuar në shtete të ndryshme si në Suedi, Gjermani, Shqipëri, Francë, SHBA dhe Itali, ku ai ka marrë pjesë dhe në Bienalen e Venecias. Helidon Gjergji është edhe lektor në Universitetin New School të Nju Jorkut.

Vendi ku do të zhvillohet projekti i bienales së Artit Bashkëkohor, D-o ARK Underground, në Konjic, është një tregues simbolik i Luftës së Ftohtë; me armët bërthamore dhe "pasojat e terrorit". Pa këto nuk do të ekzistonte një bunker i këtyre përmasave dhe në këtë formë.

Tre vjet më parë, nismëtarët e projektit të Bienales të Artit Bashkëkohor e kanë zgjedhur këtë pikë të veçantë për fillimin e një aktiviteti ndërkombëtar, pasi kanë bërë për një kohë të gjatë hulumtime rreth temës së përgjithshme të Luftës së Ftohtë. Dy edicionet e para të Bienales, në 2011 dhe 2013, kanë trajtuar aspektet e Luftës së Ftohtë, ku kanë zgjuar interesin për njohjen e bunkerit, si një strukturë ushtarake dhe njësi komanduese për gjendjen e emergjencës, si një mbrojtje ndaj "apokalipsit" që askush nuk shpresonte se do të ndodhte ndonjëherë.

Një histori e ngjashme kjo edhe me bunkerin antibërthamor në Tiranë, objektin 0774, që u çel vitin e kaluar për herë të parë në Tiranë me projektin Bunk Art. Kjo ekspozitë pati flukse të jashtëzakonshme vizitorësh për një muaj rresht...

Ndërsa koncepti kuratorial për edicionin e 3-të të Bienales së Artit Bashkëkohor, D-o ARK Underground është përsëri periudha e Luftës së Ftohtë (1947-1989). Por kjo vetëm si pikënisje, sepse fokusi drejtohet në lëvizjet alternative sociale, politike dhe ekologjike që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe dhe kanë pasur ndikime të zgjasin deri në ditët e sotme.

Ajo çfarë edicioni i tretë hulumton është ndërtimi i historisë; çdo sistem politik, çdo ideologji, dhe në fund të fundit çdo brez ka për qëllim të rilexojë dhe rinterpretojë ngjarjet historike e të riformulojë dhe / ose ndryshojë tregimin historik.



Helidon Gjergji

Artistët pjesëmarrës në D-0 ARK Underground 3

- Leone Contini (Firence)
- Dante Buu (Rozhaja / Sarajevo),
- Efikasitet dhe Amir (Bruksel)
- Helidon Gjergji (Tiranë / New York)
- G.R.A.M. (Graz),
- Tue Greenfort (Berlin)
- Éiebke Grösch / Frank Metzger (Frankfurt / Main),
- Flaka Haliti (Mynih)
- Marlene Hausegger (Vjenë)
- Dritan Hyska (Tiranë)
- Adela Jusic (Sarajevë)
- Johanna Kirsch (Vjenë)
- Elvedin Klacar (Vienna / Sarajevo)
- Damian Le Bas (Worthing, Sussex)
- DELAINÉ Le Bas (Worthing, Sussex)
- Ralo Mayer (Vjenë) dhe Oliver Gemballa (Hamburg)
- Anna Mçarthy (Mynih)
- Damir Očko (Zagreb)
- Nikolay Oleynikov (St.Petersburg)
- Alketa Ramaj (Tiranë)
- Vahida Ramujkić (Beograd)
- Selma Selman (Bihac)
- Mladen Stilianović (Zagreb)
- Sylvia Einkerler / Stephan Köperl (Stuttgart)

Përkthimi

Visar Zhiti promovon "Perëndia mbrapsht dhe e dashura" në Itali

— Romani i Visar Zhitit "Perëndia mbrapsht dhe e dashura", përkthyer në italisht nga Elio Miracco do të përurohet në Romë, më 22 prill 2015. Aktiviteti do të mbahet në librarinë e njohur "Fandago", pranë parlamentit italian. Të pranishëm në promovim do të jenë Mario Bova, presidenti i "Occhio Blu", përkthyesi Elio Miracco, i cili është edhe drejtues i Katedrës së Albanologjisë në Universitetin "La Sapienza" në Romë, dhe presidenti i shtëpisë së njohur botuese italiane "Rubbettino", Luigi Franco. Romani i Visar Zhitit "Perëndia mbrapsht dhe e dashura" u botua në Tiranë në vitin 2004 nga "Omsca-1". Kritika e vlerësoi këtë roman për origjinalitetin artistik dhe për ngjarjet rrëqethëse nga jeta në burgjet e grave dhe nga fushat e shkreta të internimeve. Romani i shkruar me vërtetësi dhe forcë të lartë artistike i ngjan një elegjie të brendshme, me etjen e bukur për jetë.



Romani në italisht, me dëshirën e autorit, mban titullin "Il visionario alato e la donna proibita" ("Vegimitar me flatra dhe grujat e ndaluar") Visar Zhiti është një nga shkrimtarët e mëdhenj shqiptarë bashkëkohorë e nga të paktit që është dënuar nga diktatura e Enver Hoxhës nga shkaku i një veprë poetike, me përmbajtje hermetike, e trishtuar dhe për më tepër e kundërt me kanonet e realizmit socialist. Pas 10 vitesh burg e punë të detyruar, me rënie e diktaturës, Zhiti pati mundësinë të botojë gjithë veprën e tij, mes të cilës dhe poezinë e shkruar fshehurazi gjatë burgimit. Përtej ndihmesës tepër të lartë e origjinale në panoramën letrare ballkanike, romanet e tij si dhe esetë e tjera kanë konsoliduar lirinë intelektuale dhe jetën demokratike në Shqipëri. Librat e tij janë përkthyer në mjaft vende, (nga SHBA në Maqedoni, nga Rumania në Itali) duke marrë vlerësimet të rëndësishme. **Dhu.Ha.**

TURQI

Gjuha shqipe dotëmësohet edhe në Ankara



— Pas kurseve të gjuhës shqipe në Stamboll dhe Izmir, më 22 prill fillon kursi i gjuhës shqipe edhe në Ankara. Këto kurse do të zhvillohen në mjediset e Qendrës Kulturore Shqiptare "Sami Frashëri" dhe tanimë janë shpërndarë formularët e regjistrimit për të mësuar gjuhën shqipe. Kjo është një sipërmarrje e studentëve shqiptarë në Ankara dhe veçanërisht e Unionit Studentor Shqiptar në Turqi (Ankara) në vazhdim e aktiviteteve të ndryshme që ky union po zhvillon me studentët e shqiptarë nga të gjitha trevat që studiojnë në Universitetet shtetërore ose private në Ankara. Ky kurs gjuhe, krahas mësimit të gjuhës mëmë, pritet të kontribuojë edhe në njohjen e shqiptarëve me njëri-tjetrin, në përfundimin e kulturës dhe traditës si dhe përfshirjen e tyre në aktivitetet e ndryshme që organizohen si nga Unioni Studentor Shqiptar në Turqi, Ankara ashtu edhe nga Ambasada e Shqipërisë dhe Kosovës. Kjo është hera e parë që hapen kurse të rregullta të gjuhës shqipe në Ankara.

» INTERVISTA

ËNDRRA që kisha që në Shqipëri filloi të bëhej realitet, që kur fillova studimet në Akademinë e Brerës, në Milano, ku pata fatin të njihja artistët dhe kritikët më të mirë të artit italian



Miloti në studion e tij në Firençe, 2014



Skulptura "La Venere" e Miloti, 2011

Alfred Mirashi: Pse e bëra Milotin emër arti

Artisti shqiptar rrëfen triumfin e ëndrrës së tij në Itali, pas largimit nga Shqipëria me eksodin e '91-shit

DHURATA HAMZAI
TIRANE

U largua drejt Italisë si shumica e shqiptarëve të suksesshëm në botë, me atë anijen e marsit të vitit 1991, në kërkim të ëndrrës, të shpresës. Bashkë me të qarat e fëmijëve, frikën dhe akthin e nënave ishte nisur drejt një fati të panjohur...

Alfred Mirashi, as që mund ta mendonte se një ditë do të kthehej në Shqipëri me një emër të madh si artist apo si kurator i një bienaleje prestigjioze të Italisë, për të cilën është munduar ta sjellë në atdheun e tij. Bëhet fjalë për Bienalen e Torinos, "Stemperando", që qëndron ende e çelur në Muzeun Historik Kombëtar, ku Alfred Mirashi-Miloti ka edhe veprat e tij.

Alfred Mirashi ka lindur në një qytetëzë të vogël të Shqipërisë, emrin e të cilit e ka kthyer në emrin e tij të artit, Milot. E ndjen se nga Miloti ka marrë me vete zemërbardhësinë dhe dashurinë për ngjyrat e jetën. Edhe pse familja e tij ka vuajtur nga diskriminimi kiasor në diktaturë, sepse ishte shpallur "familje kulakësh", Miloti rrëfen se asnjëherë nuk u ndje i tillë nga njerëzit e këtij qyteti. Miloti në kohën e diktaturës ishte qyteza që mbliktte njerëz nga e gjitha Shqipëria, sidomos nga zonat veriore. Në fantazinë fëmijore të tij kanë mbetur kostumet entografiketë mirditorëve e zadrimorëve, ku gërshtimi i ngjyrave me elementët dekorativë ishte art më vete. Aktualisht artisti shqiptar, Alfred Mirashi-Miloti, jeton në qytetin e Firences, i njohur ndryshe edhe si qyteti i artit.

Është kthimi i tij i parë i artistit në atdhe me vepra, ndërkohë që në vendet tjera të Europës pikturat dhe skulpturat e tij janë ekspozuar prej vitësh. Disa strehohen në galeri e koleksione arti

dhe shumë të tjera janë vlerësuar me çmime prestigjioze. Një ndër to është edhe vepra "Çelësi" i Miloti që fitoi Medaljen e Artë në Londër: një çelës që tregon hapjen filozofike, ku siç kuptojmë nga kjo intervistë, Alfred Mirashi është është brumosur me këtë çelësi që fëmijë. Për "Shqiptarja.com" artisti rrëfen udhëtimin e tij artistik, gjatë cilit mban me krenari emrin Miloti, emrin e vendlindjes së tij.

Prej vitësh, ju Alfred, jeni njohur me emrin e artit Miloti, emri me të cilin jeni bërë i njohur në Itali. Pas sa vitësh ktheheni me krijimtarinë tuaj në Shqipëri?

-Në Shqipëri unë vij çdo vit, por me veprat vij po vij për herë të parë së bashku me bienalen e letrës "Stemperando". Për mua është megjithatë një kthim në Shqipëri, si fitimtar, sepse prej vitësh unë nuk kisha të drejtë të bëja Akademinë e Arteve në vendin tim, për shkak se vija nga një familje kulakësh dhe ju e dini sesi ishte historia e luftës së klasave të kombit tonë, të vendit tonë, për fat të keq. Por unë megjithatë e dua vendin tim dhe kthehem këtu i lumtur se arrita të sjellë në vendin tim një bienale ndërkomëtare që bëhet vetëm në territorin italian. Dhe kjo nuk ishte aq e lehtë.

Ju keni ikur si shumica e artistëve shqiptarë, që u shquan më pas në Itali, me anijen e famshme të '91-shit. Ishte një ikje historike. Jeni kurioz të dimë sesi i keni kapërcyer vështirësitë e mërgimit për të arritur tek ëndrra jote në Itali?

-Në vitin 1991 unë isha në Durrës dhe aty kisha shansin që të nisesha me atë anije në Itali. Sa shkova atje punova dhe ëndrra ime ishte që sa të siguroja pak të ardhura të bëja një akademi arti. Zgjodha Akademinë e Brerës. Për mua ishte fat i madh, jo se akademitë e tjera janë më poshtë në Itali, por Akademia e Brerës është e famshme tashmë për emrat e mëdhenj të artit që ka nxjerrë. Në vite 2000 unë fillova ekspozitat e para Brera dhe aty sikur m'u hapen rrugët. Ëndrra që kisha që në Shqipëri filloi të bëhej realitet, që kur fillova studimet në Akademinë e Brerës në Milano, ku pata fatin të njihja artistët dhe kritikët më të mirë të artit italian. Falë dëshirës dhe impenjimit tim arrita të fitoj bursën "Erasmus" në Angli, e cila më mundësoi mua një njohje të muzeve e artit botëror. Kur shkova në Londër mësova dhe gjuhën angleze. Por ato që më shkojnë në mendje është se çdo gjë nuk arrihet lehtë dhe me sakrificë do të arrija këtë.

Thuhet që një njeri në çdo vetë është artist dhe kështu që e merreni mend se çfarë sakrificash duhen për të arritur një individualitet të spikatur. Megjithatë, mendoj se etapa e zhvillimit si artist ka qenë ajo e Akademisë së Brerës, e kjo falë faktit se aty kishte shumë studentë nga e gjithë bota. Çdo njëri prej studentëve tregonte eksperiencën e vet në art. Në fund të vitit të katërt, në muzeun e artit modern në Milano pata fatin e madh që fitova çmimin e parë mes 4.000 studentëve të pikturës. Unë u rrita si artist duke marrë pjesë nëpër ekspozita, duke vizatuar, pikturuar e duke bërë skulptura. Tani kam fatin të jetoj në Firence. Firençe më ka frymëzuar shumë sepse çdo rrugë ka skulptura, ka një arkitekturë të mahnishtme. Unë kam një skulpturë që quhet OPEN, me të cilën u prezantova në Venezi dhe tani ndodhet në Muzeun Internacional në Portofino.

Pse zgjodhët emrin e artit Milot?

-Kur kam filluar studimet në Itali, për shqiptarët nuk kishte një imazh të mirë. Dëshira për të treguar se si shqiptar unë nuk kisha asgjë për të cilën duhet të turpërohesh, më solli ndër mendje idenë që të vendos si emër arti emrin e qytetit Milot, sepse e gjithë ajo që unë isha si artist në Itali, ishte falë qytetit ku i lindi e u rrita. Veç kësaj, unë e adhuroj Karavaxhon dhe duke ditur se ai mbante emrin e vendlindjes, mendova ta vendos edhe unë emrin tim Milot. Mendova, ku i dihet, mund t'ia dalë të kem sukses dhe bashkë me emrin tim ngelet dhe emri i vendlindjes. Unë në Milot kam lindur dhe aty kam kalur fëmijërinë. Ndoshta atëherë nuk kisha interesa artistike, por unë aty kam përjetuar të gjitha emocionet dhe mbresat njerëzore që të bëjnë një ditë artist me vepra. Miloti për mua ka qenë edhe një vend i larmishëm, ku ishte shembulli i të jetuarit bashkë myslimanë e katolikë, me jevgjit e romët. Ishte vendi ku kultura e zakone të ndryshme sillnin një larmi të madhe në këtë bashkëjetesë. Ditën e pazarit në Milot, unë me kureshtje shihja etnografinë e veshjeve të mirditorëve, zadrimorëve, etj. Në Milot unë mësova dashurinë për ngjyrat, për shijet dhe preferencat e ndryshme të një filozofie jetësore pa paragjykimë. Kostumet kombëtare i shihja me dashuri dhe kuriozitet. Më tërhiqte larmia dhe veçantia e gjithësecilit kostum që përfaqësonte një popullsi ose kulturë të zonave të caktuara. Edhe nëna ime vetë qëndiste shumë bukur. Nga duart e saj dilnin figura që më dukeshin magjike. Me vite pune, tek unë zgjohej këto motive, këto mbresa dhe bëhen pjesë e veprës sime. Unë mund të them se ajo që arrita në punën vjet me vite pune. Fakti që unë iu dedikova artit pa forma ideologjike apo partiake, më ndihmoi në Itali të punojë pa kufizime dhe arrita të vlerësohem mes artistëve të botës atje.



A. Mirashi-Miloti dhe kritiku italian, doc. Sanfo Vincenzo, duke i dhënë çmimin në pikturë në Muzeun Eater Cube të Pekinit 2013, në Kinë.



Miloti përballë pikturës që ka marrë çmimin "Medalja e Artë" në Londër 2012

Champions pa yjet Bayern-PSG luajnë përmbysjen e madhe

Në çerekfinale mungojnë Bale, Modric, Silva, Pogba, Vidal, Riberi, Roben, Shvainshtager, Alaba, Martinez



Mungesa

Do të ketë Bayerni sonte përballë Portos. Riberi, Roben, Martinez, Alaba janë mungesa të sigurt, ndërsa në luftë me kohën është mesfushori Shvainshtager.



Shifrat



2

Gola

I duhen Bayernit për të kthyer rezultatin e ndeshjes së parë, por njëkohësisht të mbajë të paprekur rjetën, pasi në të kundërt kualifikohet Porto.



2

Lojtarë

Do t'i mungojnë Juventusit nesër në ndeshjen me Monaco, Pogba dhe Vidal. Po 2 mungesa do të ketë edhe Reali, pasi Modric dhe Bale janë të dëmtuar.



3

Gola

I shënoi Porto ndeshjen e parë Bayernit duke udhëtuar në Gjermani me një rezultat komod, por jo të sigurt, pasi duhet që të jenë vigjilentë

DYLBËR BALLA
TIRANË

Bayern Mynih dhe PSG do të luajnë sonte shanset e fundit për të shmangur eliminimin nga Champions League. Kampionët e Gjermanisë kanë një sfidë shumë të vështirë përballë Portos, që këtë edicion po rezultoi surpriza e Champions League, pasi në ndeshjen e parë shtangur Guardiolaën duke e mposhtur 3-1 në Portugal. Megjithatë ende nuk ka mbaruar asgjë, pasi me një fitore 2-0 Bayerni kalon në gjysmëfinale, por kur mendon që Pep nuk do të ketë në dispozicion krahët e sulmit, Roben- Riberi, mushkërinë e mesfushës, Bastian Shvainshtager, por edhe Martinez dhe Alaba duket situatë e komplikuar. Ndeshja e parë përpos formës së dobët të Bayernit u vendos edhe nga gabimet, duke u dhënë mundësi portugezëve që të shënonin shumë shpejt, një gjë të tillë Guardiola kërkoi ta shmangë në ndeshjen e sotme duke kërkuar përçmërim maksimal. "Porto është një kundërshtar i fortë fizikisht, mund të na vendosë sërish në vështirësi nëse nuk do të tregohemi të kujdesshëm. Nëse besojmë deri në fund mund të kthejmë rezultatin dhe të kualifikohemi. Kemi mungesa, por besoj se do të jemi në gjysmëfinale. Jam optimist 100% mbi mundësinë e kalimit, jetoj për këto ndeshja" tha ai. Ndërsa sulmuesi Muller shton se "Një fitore 2-0 në shtëpi kundër Portos nuk do të ishte një mrekulli. Nuk është e lehtë të përballësh me presionin, por tek e fund kjo është vetëm një ndeshje futboll". Ndërsa ndeshja tjetër që do të zhvillohet sonte është Barcelona-PSG. Spanjollët janë një hap larg turit tjetër, por trajneri i katalanasve shmang euforinë, teksa shprehet se parisenët mund të kalojnë në gjysmëfinale. "Kemi rezultat të mirë 3-1, por jo shanse të mëdha. Mund të jemi në gjysmëfinale, por mund të kalojë edhe PSG. Për këtë ne duhet ta sulmojmë. Ta mbajmë topin, të ballafaqohemi me presionin" tha Enrique. Për ekipin e PSG i vetmi lajm pozitiv është rikthimi i Ibrahimovic dhe Verratti, por në dyshim është kapiteni Silva, që pësoi një dëmtim ndeshjen e parë në Francë.

NESËR

Dy sfidat e mbetura çerekfinale, Real Madrid- Atletico Madridit dhe Monaco-Juventus do të nxjerrin nesër 2 ekipet e fundit që do të plotësojnë 4 gjysmëfinalistët për këtë edicion. Sfidat janë të paparashikueshme, pasi derbi madrilen ka dhuruar vitet e fundit gjithmonë surpriza. Edhe pse Reali është i favorizuar, mungesat e Modric dhe Bale, por edhe dyshimi mbi Benze-

ma luhatin fuqinë e kampionëve në fuqi duke e bërë më komode sfidën për Atletikon. Megjithatë trajneri i Reali, Anceloti shprehet se "Nuk jam i shqetësuar për dëmtimet. Kam lojtarë të mjaftueshëm që mund t'i zëvendësoj. Me Atletikon kërkojmë kualifikim vetëm me fitore" tha ai. Problemeve me lojtarët nuk u ka shpëtuar as Juventusit që për sfidën përballë Monaco nuk do të ketë në dispozicion dy

lojtarë kryesorë. Kështu pas dëmtimit të Pogba, Alegri nuk do të ketë në dispozicion as kilianin Vidal, i cili sipas mediave italiane ditët e fundit ka pasur probleme me bajamet duke qenë në rrezik për ndeshjen e nesërme. Sipas të gjitha gjasave, Alegri duhet të privohet nga mesfushori duke krijuar shumë boshllëk në mesin e fushës, përballë një kundërshtari surprizë dhe një rezultati që mund të kthehet.

KOMBËTARJA

Cremonese e mohon kalimin e Rey Manajt te Juve për 2 mln Euro

Cana përpos Gjermanisë dhe Turqisë oferta edhe nga Rusia nëse do të largohet nga Italia

Lojtari 18-vjeçar me origjinë shqiptare Rey Manaj i bashkohet ekipit të Juventusit në kampionatin italian të futbollit sipas mediave të vendit fqinj. Kampionët e Italisë vëzhgimin prej kohësh të shqiptarit e kanë konkretizuar me një ofertë konkrete që shkon sipas mediave italiane 2 milionë Euro. Tashmë në përfundim të këtij edicioni, Manaj do të transferohet te Juventusit për të nisur aventurën me ngjyrat bardhezi. Rey Manaj ka dalë nga akademja e Cremonesës, ndërsa në sezon 2013-2014 u transferua në formë huazimi te Samp-

doria, por klubi nga Gjenova nuk pranoi ta blinte kartonin. Manaj është aktivizuar në dy ndeshje me përfaqësuesen U-19 të Shqipërisë, ndërsa me U-21 debutoi me gol në fitoren 2-0 nga Lihteshteinit në eliminatorët e Europianit të vitit 2017. Por Cremonese disa orë pas publikimit të lajmit përmes një komunikatë për mediat ka mohuar shtjën e sulmuesit shqiptar te Juventusit, duke këmbëngulur se Manaj vazhdon që të jetë pjesë e ekipit. "Sqarojmë se nuk është mbyllur asnjë tratativë për transferimin e futbollistit Rey Manaj te Juventus. Sulmuesi është në pronësi të Cremonese"- thuhet në faqen e klubit italian. Sipas "neescalcio.comercato.eu," kapiteni i Shqipërisë, Lorik Cana që luan me Lazio dhe ka kontratë deri më 2016 ka marrë oferta të fundmi edhe nga Rusia nëse do të largohet nga Italia. Përpos Ruisisë, për Canën janë të interesuar edhe ekipe nga Turqia dhe Gjermania.



Shkurt

SHORTI EURO 2017

Vajzat shqiptare përballë Francës, Ukrainës e Rumanisë

— Kombëtarja e femrave ka njohur kundërshtarët për eliminatorët e Kampionatit Evropian të 2017. Vajzat e drejtuara nga Altin Rrakllit janë pjesë e grupit të tretë ku ndodhet edhe Franca, Ukraina e Rumania. Skuadra e Rrakllit ka si kundërshtar më të vështirë Francën, që është pjesë e fazës finale rregullisht prej vitit 1997. Vajzat franceze renditen të dytat në klasifikimin e UEFA-s. Faza finale do të mbahet në vitin 2017 në Holandë me 16 kombëtare.

KUPA E SHQIPËRISË

Tirana dhe Skënderbeu luajnë shanset e fundit për finalen

— Nesër do të zhvillohen 2 ndeshjet e kthimit të vlefshme për gjysmëfinalen e Kupës së Shqipërisë. Skënderbeu pret në shtëpi ekipin e Kukësit, teksa ndeshja e parë në verillindje përfundoi me fitoren e nënkampionëve 1-0. Ndeshja tjetër zhvillohet në Laç, aty ku vendasit presin Tiranën. Shanset janë që Laçi të kalojë më tej, pasi ndeshja e parë në Tiranë përfundoi me rrjeta të paprekura.



PARADE FJALEKRYQESH

NGA KADRI VOKOPOLA



VIDEO/
JA SI ABIGAIL
RATCHFORD LAN
MAKINEN



Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të A1REPORT që shkarkohet falas

HOROSKOPI

- Dashi** Planetët do jone te pozicionuar mire sot ne jetën tuaj ne çift dhe gjithëka ka për t'u ecur si duhet ju te dashuruarve. Dëgjoheni zemër dhe besojni vetëm asaj. Beqaret ka mundësi te mos dalin neper takimet qe kane lënë për shkak te disa punëve me rëndësi qe do i jepen. Financat nuk do jone te këqija, megjithatë pak maturi me shpenzimet nuk do sillte asgjë te keqe.
- Demi** Ka shume mundësi qe te bëni projekte për te ardhmen ose te mendoni për ndonjë udhëtim gjate kësaj dite ju te dashuruarit. Do ndiheni te lumtur. Beqaret gjithashtu do jone me fat dhe mund te gjejnë personin e tyre te ëndrave. Ne planin financiar, gabimi me i vogël mund te sjelle tronditje te mëdha sot. Tregohuni sa me te matur qe te mundeni qe te shmangni problemet.
- Binjakët** Dite shume e paqëndrueshme kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Do konfliktoheni gjate gjithë kohës me atë qe keni ne krah dhe do mendoni te qëndroni larg. Beqaret do afrohen edhe me tepër me një person te cilin kane kolhe qe e studiojnë. Financat do kërkohen shume durim dhe përkujdes ne mënyrë qe te përmirësohen. Po ja dolët sot do ndiheni te qete për shume kohe.
- Gaforja** Dite shume e turbullt kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Nuk do ndiheni aspak te qete dhe mund te keni mosmarrëveshje te mëdha. Beqaret do fillojnë një lidhje pasionante e cila mund t'ua ndryshoje përgjithmonë jetën. Ne planin financiar do kaloni shume vështirësi dhe vetëm ndihma e familjareve do mund t'ju nxjerre nga situata delikate.
- Luani** Do i jepni me shume prioritet se kurë me pare sot jetës ne çift dhe do bëni gjithëka qe gjerat te ecin mbare. Yjet do i keni ne anën tuaj. Beqaret do ndihmohen nga Marsi dhe do arrijnë te joshin një person interesant dhe me shume vlera. Gjendja e financave mund te ketë disa probleme te vogla sidomos për ata qe kane kryer investime te mëdha.
- Virgjësi** Me ne fund klima do te ngrohet për ju qe jeni ne një lidhje. Do flisni për gjithëka me partnerin dhe bashkëpunimi do te përforcohet. Edhe për beqaret do te nise një periudhe e re dhe miqjt e bukur. Nuk do jeni me vetëm fale një takimi te vegante qe do kryeni. Ne planin financiar do kryeni transakcione te rëndësishme. Mundohuni me sa keni mundësi te hiqui edhe ndonjë lek mënjëra.
- Peshorja** Klima planetare do favorizojë dashurinë ne çift gjate kësaj jave. Do i zgjidhni te gjitha problemet qe iu mundtoni dhe ndiheni me te qete. Beqaret do jone te turpshëm dhe kjo nuk do i lejojë te përfillojnë kjo mundësi qe do i jepen. Mundohuni te tregoheni pak me te hapur dhe hiqui tek. Sektori i parave do influencohet negativisht nga Plutoni. Nuk është momentu te rezkoni.
- Akrepi** Mos reagoni pas çdo kritikë qe do iu beje partneri sot. Pasi te reflektoni mire do e kuptoni qe ai ka te drejte. Tregohuni te gëshëm te bëni lëshime. Beqaret do kenë aq shume dëshirë te krijnë një lidhje saqë nuk do oqesin shume e do lidhen me te panin qe do iu dale para. Ky do jete një gabim. Për sa i përket financave ato nuk do jone te qëndrueshme, prandaj përsni edhe pak para se te bëni transakcione.
- Shigjetari** Shume vështirësi dhe probleme do ketë sot ne jetën tuaj ne çift. Nuk do ju bindeni atyre qe do ju thotë partneri dhe kjo do krijnë here pas here mosmarrëveshje. Beqaret nuk do ndihen gati te bëjnë ndryshime ne jetën e tyre dhe do i refuzojnë edhe ftesat qe do ju bëhen. Financat duhet t'i mire organizoni dhe do e shihni qe gjendja do ju përmirësohet me shpejt nga sa mendoni.
- Bricjapi** Do jeni me romantike gjate kësaj dite ju qe jeni ne një lidhje dhe do përjetoni emociot te veganta. Do i jepni edhe me tepër rëndësi intimitetit te cilin e kishit lënë pak pas dore. Beqaret do kenë mundësi etem për aventura te këndshme. Dashuria e madhe nuk do vijë as sot. Ne planin financiar do kryeni shpenzime me te mëdha se te ardhurat qe keni. Kjo do sjelle probleme.
- Ujori** Do e keni me te lehte sot te kuptoheni me atë qe keni ne krah. Tregohuni me tolerante dhe pranojnini gabimet tuaja. Mos harroni as te përdorni fjalët e embla e te ngrohta. Do jone te shume planetët qe do influencojnë ne jetën sentimentale te beqareve. Personat qe do takoni do jone sipas shijeve tuaja. Financat do jone te shikëlqyer. Jo vetëm qe do e stabilizoni buxhetin por do hiqui edhe ndonjë lek mënjëra.
- Peshqit** Ata qe janë ne një lidhje do kenë një rëzgjim te pasionit sot. Do kaloni momente te mrekullueshme me atë qe keni ne krah dhe nuk do doni qe dita te mbarojë. Beqaret qe nuk e kane gjetur ende shpirtin binjak ka shume mundësi te gjejnë sot. Ne planin financiar situata nuk do jete e mire. Do iu duhet te merrni hua qe te mos keni probleme.

FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI 33 KUTI

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1																	
2																	
3																	
4																	
5																	
6																	
7																	
8																	
9																	
10																	
11																	
12																	

HORIZONTAL

- Janë të dërguar speciale
- Ata të përqendrimi janë të tmerrshëm.
- Janë publikë si baret.
- Takime Sportive Lokale
- Rrallë është përgjysmë.
- Është mister.
- Janë pjesët e hekurta.
- Fillojnë një meeting
- Dy asa.
- Drejtohen për të bërë zoom.
- Një kolegi i famshëm anglez.
- Është linja për... të folur.
- King Cole i muzikës.
- Janë ata që gënjyjnë për tubë të famshëm.
- Një pjesë e shiritit.
- Një krye të trupave.
- Është femijë.
- Fillojnë mbarë.
- Fund filmi.
- Zanore ahengu.
- Gjysmë raketë.
- Janë sportive të tilla të Alban Xhihanit.
- Ora këngëtare.
- Kështu fillon numërimi.
- Te fundit në tender.
- Një ekspres në binarë.
- Henri piktor.
- Është nivel... zhvillimi.
- Fillojnë sefte.
- Janë për të mbështjellë foshnjat.
- Me te nxjerrin një tapë.
- Është figurë geometrike.
- Demek's ka kufji.
- Është gjuha e Dantes.


VERTIKAL

- Kështu është gabimi më i thjeshtë.
- Incialet e Eluard.
- Janë vlerat me para.
- Një pjesë e memories.
- Institucione Kombëtare Informative.
- Fundit i Turandot.
- Janë male në Rusi të tilla.
- Françoise që shkroi Bonjour tristesse.
- Mitet pa kufji.
- Emër vajze.
- Mia që qe këngëtare italiane.
- Chris këngëtar.
- Shtetet pa set.
- Janë kamponë të skuadrës.
- Mbetet në fund.
- Është ushtarak i rangut të ulët.
- Festa pa fe.
- Janë ata që janë të dhënë pas operas.
- Ishte djali i Odiseut.
- Fundi i një samurat.
- Incialet e Mathieu këngëtare.
- Qytet fermal belg.
- Janë fjalëpakë.
- Diane aktore.
- Duhen respektuar në kohë të tilla.
- Është spektakolar ai polar.
- Incialet e Mathieu këngëtare.
- Fillojnë dobët.
- Një ëmbëlsirë.
- Është edhe ai solemn.
- Janë dhembët e parë.
- Ekstre me në numër.
- Një krye të brigatës.
- Janë në verë.
- Tregohet me hollësi.
- Nuk ka... harbuti.
- Një bishë... ridens.



Përgjigje e fjalëkryqit pa skemë

FJALËKRYQI SPORTIV



HORIZONTAL

- Ai i kuq dëbon nga loja.
- Fillojnë takimin.
- Igji te Lazio.
- Një sigël për maune.
- Ishte kampione e volebollit të Dinamos.

- Një sigël për tenistë.
- Është medalja e të parit.
- Personazhi në foto.
- Te parat në slalom.
- Kshtu brohorasin të fozët Fierakë.
- Antena pa çifte.

- Mbyllin portat.
- Ekstre me rebel.
- Ndërmarrje Lokale Ndërtimi.
- Pak singeritet.
- Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.
- Zanore për perime.
- Eugenio, trener italian.
- Gjysma e lutjes.
- Agjenci Ajr ore Greke.
- Personazhi në foto.

VERTIKAL

- Është skuadra e... parë.

Sudoku

	9							8
6		5		2		1		3
1	3			8			5	7
9			5	4	6			8
5		8	1		3	6		9
3			2	9	8			5
7	6			1			3	2
8		3		6		9		1
	1							6

Përgjigje

5	3	1	6	7	9	8	4	2
4	9	7	2	8	1	6	5	3
2	8	6	3	5	4	1	7	9
8	2	3	5	1	7	9	6	4
1	7	9	4	2	6	3	8	5
6	5	4	9	3	8	7	2	1
7	4	5	1	6	3	2	9	8
9	1	8	7	4	2	5	3	6
3	6	2	8	9	5	4	1	7

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo rresht e kolonë të ketë numrat nga 1-9

FJALEKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

Përgjigje



SHKRONJA E NJËTË PËR NUMËR TË NJËTË

5	H	A	R	E	6	2	10	5	11	3	9	3
1	6	1	8	2	9					16	2	10
7	1	6	2		6	2	5	2	9	2	10	
3	7			6	2	12	1	8	3	13	2	7
9	2		5	2	6	2	12	1	8	2		1
4	8	2		5	2	10	2	12			2	12
8	1	7		2	12	14		2	6	1	12	3
1	7	4		3	12	13		7	1	7	1	
		9	4		2	7	1		10	3	7	2
2	12	3		6	8	2	16	2		11	9	
9	2	11	3	13	1		2	12	6	2	13	4
11	8	1	16	2	7	3		7	14	2	10	

Përgjigje e fjalëkryqit sportiv



- Markë makine.
- Një pjesë e rezultatit.
- Roth aktor.
- Ortega ish-futbollist.
- Është kampion që... fitohet.
- Giuseppe, që qe as i ciklizmit italian.
- Me break për të fituar set-in.
- Karl që qe "postierit" i NBA.
- Janku ish-arbitër.
- Duhet shfrytëzuar për kundërsulm.
- Një sport në... lumë.
- Huton pa zë.
- Mbaron në finish.
- Përsëriten në kala.
- Incialet e Paganini-t.
- Kufizojnë grupin.
21. dyti në kapitull.
- Altin ish-mesfushor.
- EL. Agjiero.
- Me të nxjerrin trarë.
- Fillojnë turnin.
- Hapin sezonin.

LAJME nga bota

Tërhiqet ftesa për Thaçin në Serbi

Drejtori i Zyrës për Kosovën në qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriç ka deklaruar se zëvendëskryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, nuk ka kërkuar zyrtarisht leje për të vizituar Beogradin. As Serbia nuk ka organizuar ndonjë takim, ku ai të mund të marrë pjesë, ka thënë Gjuriç për televizionin publik serb. Duke nënvizuar se një aktivitet të tillë nuk e ka organizuar as bashkësia ndërkombëtare, zyrtari serb ka theksuar se "kjo është një stuhë në gotën e ujit dhe një shmangie e vëmendjes nga temat më të rëndësishme". Ndërkohë, dje organizata jofitimprurëse, që e kishte ftuar ministrin Kosovar të Punëve të Jashtme, njoftoi se e kishte anulur ftesën.

Një milion emigrantë drejt Evropës

Janë rreth 1 milion emigrantë të paligjshëm gati për të mbërritur në Europë. Ky është alarmi që lëshon prokurori i Palermos, Maurizio Scalia, i cili sqaron se emigrantët qëndrojnë në brigjet e Libisë e gjithë Afrikës Veriore, të gatshëm për të ndërmarrë sakrificën e rrezikshme drejt vendeve të BE-së. Sipas prokurorit ka një trafik të pandalshëm personash, që shfrytëzohen nga trafikuesit e qenieve njerëzore. Udhëtimi nga Libia kushton rreth 5.000 USD përmes shkretëtirës, më pas duhen 1.500 dollarë për udhëtimin në det. Pas mbërritjes në brigjet italiane, refugjatët detyrohen të paguajë sërish rreth 1.500 dollarë për të mbërritur në Europën Veriore.

Agimi i Artë, organizatë kriminale

Gjyqi ndaj lidershit dhe anëtarëve të Agimit të Artë, i cili filloi mëngjesin e së hënës në Athinë, u shty për në 7 maj, për shkak të raportimeve për sulme ndaj dëshmitarëve. Dëshmitarët e vrasjes së Pavlos Fyssas - muzikantit antifashist të vrarë nga neonazistët në vitin 2013 - u sulmuan nga mbështetësit e Agimit të Artë, para se ata të arrinin në burgun e Koridhallos. Për të parën herë pas Luftës së Dytë Botërore ulet në bangën e të akuzuarve një parti parlamentare. Ndaj të pandehurve rëndonjë akuzat e krimit dhe pjesëmarrjes në organizata kriminale.

abissnet¹⁵
PERJETONI SHPEJTESINE!

More TV
More color to your television!

Përjetoni maksimumin me 3 Play More

Instaloni internetin më të shpejtë në Shqipëri duke zgjedhur Fibrën Optike apo ADSL, për ofertat më të mira dhe të lira në treg

Dekoderi Android i MoreTV, ju jep shumë më tepër se një listë kanalesh të përzgjedhur. Shndërrojeni TV tuaj në një kompjuter të vërtetë

Rizbuloni telefonin duke marrë telefoninë fikse me Abissnet dhe përftoni tarifat më të ulëta në treg, pa asnjë tarifë mirëmbajtjeje

+355 4 4300 123 | sales@abissnet.al | facebook.com/Abissnet | www.abissnet.al

Alba Malltezi - Drejtore e Përgjithshme e Free and Fair Media Group ; Aurel Pepa - Zv/Kryeredaktor
 Genc Kondi - Administrator i Përgjithshëm; Admirina Peçi - Kryeredaktore e "Rilindasi"; Politika: Juxhin Mustafaraj; Ekonomi: Lorenc Rabeta; Aktualitet: Elton Qyno ;
 Sociale: Sonila Isaku; Kulturë: Dhurata Hamza; Sporti: Dylber Balla; Design: Altin Allaj, Erjon Ymeri; Website: Greta Malaj; Shpërndarja: Spiro Meshini cel: +3556960088847
 Departamenti i Marketingut:
 Vera Përleka
 Cel: +355696060419
 marketing@shqiptarja.com
 Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: redaksia@shqiptarja.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: KLASS shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë